



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe
“Menaxhim Marketingu”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit -
KUB”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Arjan Qefalia

2. Prof.Asoc.Dr. Gentiana Kraja

Gusht 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit - KUB”

| | | |
|-----|---|---|
| Nr. | | |
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Universitar i Biznesit |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Menaxhimit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR nr. 277 datë 02.07.2012 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | MASR Nr. 3715/1, datë 30.07.2019 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër 158, dt.07.04.2017 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | UMASR nr.562, datë 30.11.2016/VKA nr.200, datë 17.10.2016 |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite (4 semestra) |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë e plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | V.A 2022-2023 – për vitin e parë, 9 PAE/2 PAK për PS MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik” dhe 9 PAE/2 PAK në atë me profil “Menaxhim Marketingu |
| 18 | Numri i studentëve: | V.A 2022-2023 6 studentë të regjistruar në PS MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik”, dhe 12 studentë në atë me profil “Menaxhim Marketingu |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” është një program studimi me kohë të plotë, me 120 kredite, që ofrohet në 4 semestra apo 2 vit akademike, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilave merret diploma me profilet përkatëse. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.651, datë 14.09.2011 është bërë licencimi i Akademisë Profesionale të Biznesit. Me Urdhërin nr.277, datë 2/07/2012 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është hapur programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” pranë Akademisë Profesionale të Biznesit (sot Kolegji Universitar i Biznesit). Në vitin 2019 programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi”, është riorganizuar më MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Programi i studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit, njësi e vendosur në Fakultetin e Ekonomisë të IAL KUB.

IAL “Kolegji Universitar i Biznesit” ka përcaktuar qartë drejtimet prioritare akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e ‘Kartës së Bolonjës’ dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioriteteve synohet nëpërmjet përbushjes së misionit të IAL “Kolegji Universitar i Biznesit” të përcaktuar në Statutin e IAL “Kolegji Universitar i Biznesit”. Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të IAL “Kolegji Universitar i Biznesit”. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në fushën e Administrimit Publik dhe në fushën e Menaxhimit të Marketingut, etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet si specialist në organizatat e sektorit publik, si dhe në kompanitë private në fushat e lartpërmendura.

Ky raport u përgatit nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të akreditimit për programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Prof.Asoc.Dr. Arjan Qefalia dhe Prof.Asoc.Dr. Gentiana Kraja. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Rajna Lila, përfaqësuese e ASCAL.

Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, GVB, sekretarinë, zyrën e karrierës, punonjësen e bibliotekës, etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qenë kriteret e vendosura në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit Master Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vizitat në institucion u kryen në datën 15 dhe 16 Mars 2023. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL, dhe gjithashtu gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca të ndryshme për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit të nivelit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Programi i studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” është i atashuar pranë Fakultetit të Ekonomisë të IAL KUB.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” është në proces riakreditimi.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Msc. Rajna Lila.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit/Këshillit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.200, datë 17.20.2016 janë:

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.651, datë 14.09.2011 është bërë licencimi i Akademisë Profesionale të Biznesit. Me Urdhërin nr.277, datë 2/07/2012 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është hapur programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” pranë Akademisë Profesionale të Biznesit (sot Kolegji Universitar i Biznesit). Në vitin 2019 programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi”, është riorganizuar më MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”.

Programi i studimit të ciklit II MSH në Menaxhim Biznesi është akredituar me Urdhër të MASR nr.562, datë 30.11.2016 bazuar në VKA nr.200, datë 17.10.2016, vendim në të cilin janë dhënë rekomandimet:

1. Të pasurohet më tej biblioteka, veçanërisht me literaturë shtesë në mbështetje të këtij PS.
2. Të konsolidohen e diversifikohen mundësitë e financimit duke rritur dhe numrin e bashkëpunimeve me projekte kërkimore brenda e jashtë vendit.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Institucioni bazuar në rekomandimet nga vlerësimi i mëparshëm i programit të studimit të ciklit II MSH në Menaxhim Biznesi ka bërë përpjekjet e veta. Konkretisht:

1. Lidhur me rekomandimin e parë, konstatohet që IAL KUB ka bërë përmirësime në pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj. Sugjerohet që të vazhdohet në vijimësi me shtimin e titujve të librave në gjuhën shqipe dhe të huaj (sidomos të viteve të fundit) për të mbështetur nevojat e programit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”.
2. Lidhur me rekomandimin e dytë, konstatohet që IAL KUB ka bërë përmirësime lidhur me konsolidimin dhe diversifikimin e mundësive të financimit duke bashkëpunuar në projekte kërkimore brenda e jashtë vendit, të tilla si projektet me Kazazi Consulting Group, Projekti Gradua, Projekti VET, etj. Sugjerohet që të vazhdohet në vijimësi në aplikimin dhe fitimin/pjesëmarrjen e projekteve të reja në të ardhmen të cilat financohen nga BE.

**Komente të GVJ në përgjigje të shkresës nr.292, datë 7.07.2023 të IAL Kolegji Universitar
i Biznesit (KUB) mbi Draft – Raportin, dërguar ASCAL**

Sgarim: GVJ në hartimin e RVJ është bazuar në evidencat e dorëzuara nga IAL pranë ASCAL para dhe pas vizitës fizike në IAL KUB, si dhe bazuar në vizitën dhe diskutimet & takimet e bëra në IAL KUB. Sa më sipër, në mënyrë më të detajuar, qëndrimet e GVJ jepen si vijon:

GVJ në FUSHA II – Standarti II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.
– **Kriteri 2** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. ... Duke iu referuar përbërjes së kurrikulave sipas disiplinave përkatëse si edhe syllabuseve të lëndëve rekomandohet që të përshtaten më mirë me ciklin në të cilin ofrohen ashtu si edhe me profilin përkatës.

Komente nga GVB: Vlerësimi kryesisht për këtë standard është pa vend dhe e kontestojmë. Pasi për nga natyra e lëndëve dhe kurrikulat e profileve janë përcaktuar dhe hartuar nga struktura autoritare ligjore, duke ligjëruar plotësisht disiplinat shkencore dhe përmbajtjen e syllabuseve sipas profileve. Kjo do të thotë se ato janë parë me kujdes dhe përgjegjësi si nga departamenti, Fakulteti, Senati Akademik, Ekspertët e Jashtëm, para liçensimit, si dhe nga ekspertët e jashtëm në akreditimin e parë të këtij programi dhe cikli studimi, të vlerësuar me 6 vite akademike akreditim. Ndërkohë ju bëjmë me dije se në KUB, në kuadër të rishikimit të kurrikulave/programeve dhe harmonizimit të tyre me kërkesat e tregut të punës, por edhe në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe programit Erasmus+ janë bërë ndërhyrje dhe përmirësime edhe vitin e kaluar, nga Senati Akademik, të cilat janë miratuar edhe nga MASR. (dok bashkëngjitur).

Komenti i GVJ: Në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të hartuar nga ekspertët është evidentuar puna e mirë dhe korrekte e bërë me përmbajtjen e programit të studimit në drejtim të kurrikulave, të strukturës akademike dhe të procedurave me të cilat operon. Gjithsesi ka disa mundësi për përmirësime në kuadër të një përshtatje më të mirë të disiplinave dhe syllabuseve përkatëse me ciklin dhe profilin përkatës në të cilin ofrohen (duke iu referuar syllabusesve të prezantuara nga IAL për vitin 2022-2023). Pavarësisht se ofrohen në ciklin dytë të studimeve Master Shkencor, disa disiplina në syllabuset e tyre reflektojnë trajtimin në nivel fillestar dhe bazik. Nga ana tjetër pavarësisht se ofrohen me drejtim nga sektori publik në rastin e Masterit Shkencor në Administrim Publik, këto disiplina siç reflektohet në syllabuset e tyre trajtohen të orientuara nga sektori privat “biznesi”. E njëjta gjë vlen edhe për programin Master i Shkencave në Menaxhim Marketing.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standarti II.3 . Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë... – Kriteri 2 ... Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. ... *Rekomandohet që plani mësimor dhe kurrikula të pasqyrojnë klasifikimin në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje: kjo ndarje mungon, lëndët me zgjedhje mungojnë.*

Komenti i GVB: Në kurrikul është pëcaktuar tipi C “Lëndë Integruese dhe me zgjedhje”. Vetë grupi C e zgjidh këtë problem. Në planin mësimor lëndët/ lënda reflektohet me të njëjtën gërmë “C” dhe me kreditet pëkatëse, pasi ky është një standard i përcaktuar me VKM.

Komenti i GVJ: VKM përcakton kategorinë e lëndëve dhe Tipin e komponentit mësimor, si dhe peshën specifike që ajo kategori duhet të ketë në pogramin e studimit. Kështu, kategoria “C”, Tipin e komponentit mësimor e ka “LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje”, pra në këtë kategori përfshihen disa tipologji lëndësh, ndër të cilat edhe lëndët me zgjedhje. Nënndarjen sipas kategorisë respektive e bën vetë IAL. Gjithsesi, referuar planit mësimor, duke e parë nga këndvështrimi i studentit nuk është e qartë se cilat janë lëndët ndërmjet të cilave mund të zgjedhë studentin në një semestër të caktuar. Kjo gjë duhet qartësuar.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin

GVJ në FUSHA II – Standarti II.6 . Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor... – Kriteri 1 .. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. ... *Janë bërë përpjekje për ndërkombëtarizimin e programit të studimit ndërmjet programit Erasmus +, ndonëse duket se nuk ka patur një interes të madh nga ana e studentëve. Objektivi i ndërkombëtarizimit është ndër objektivat e KUB të planit strategjik të 2021 – 2026. Rekomandohet të shtohen përpjekjet dhe incentivimi i studentëve të këtij programi në shfrytëzimin e mundësive Erasmus + në kuadër të ndërkombëtarizimit.*

Komenti i GVB: Ndërkombëtarizimi 3-4 vitet e fundit është bërë pika e fortë e KUB, duke mbetur jo vetëm si objektiv, por dhe një realitet i kapur fort tek ne. Arritjet, marrëveshjet e nënshkuara me universitete perëndimore për shkëmbime studentësh dhe stafi akademik si dhe realizim projektesh në bashkëpunim me ta është një sukses i padiskutueshëm i KUB. Ky tregues duhet të vlerësohet në total si IAL dhe nuk duhet të zbehen vlerat e KUB, mqs në nivel programesh dhe sidomos në ciklin e dytë nevojitet më tepër. Mos harrojmë se studentët e këtij programi studimi kanë marrë pjesë në Erasmus + në ciklin e parë të studimeve bachelor.

Ndërkohë, KUB ka organizuar konferenca shkencore ndërkombëtare studentore dhe vizita dypalëshe në IAL ndërkombëtare.

Komenti i GVJ: Në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ekspertët kanë evidentuar punën shumë të mirë të bërë nga KUB në kuadër të ndërkombëtarizimit. Ky grup ekspertësh vlerëson këtë proces në kuadër të programeve të studimit në proces akreditimi. Patjetër që pjesmarrja e studentëve të këtyre programeve në konferenca shkencore apo aktivitete të tjera organizuar nga KUB ka qenë e

kënaqshme, por mbetet për t'u përmirësuar pjesëmarrja e studentëve të këtyre programeve në mobilitetet studentore të ofruara në kuadër të Erasmus +, mundësi që nuk është shfrytëzuar ende nga studentët e këtyre programeve.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.1 ... Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. – Kriteret 1&2 ... Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. & **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. ... *Konstatohet që në vitin e parë të programit të studimit MSH në "Menaxhim Biznesi" me profil "Administrim Publik", 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi, dhe në vitin e parë të programit të studimit MSH në "Menaxhim Biznesi" me profil "Menaxhim Marketingu", 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi. Sugjerohet në të ardhmen që të ketë angazhim dhe të pedagogëve/profesionistëve të tjerë, ekspertë të fushës, kjo në interes reciprok të IAL dhe studentëve.*

Komente nga GVB: Programi ka dy profile dhe vetë programi, por mbi 80% e lëndëve janë të njëjta dhe jepen në kuadër të një grupi mësimor studentësh, pasi numri i tyre është i vogël për të zhvilluar mësim secili profil në vete. Për më tepër, ngarkesa e stafit për vitin akademik është minimale për pedagog, gati sa 60-70% e ngarkesës totale të pedagogut në sektorin publik. Për këtë arsye nuk ka mbingarkesë apo përqëndrim të lëndëve në një numër të pakët pedagogësh. Shqetësimi i ekspertit për ngarkesën akademike nuk qëndron.

Komente nga GVJ: Gjatë vizitës zyrtare të ekspertëve në IAL, iu kërkua IAL dërgimi (uplodimi) i planeve mësimore përkatës për PS për të dyja profilet e të shoqëruara dhe me emrat e pedagogëve përkatës për çdo lëndë në të dyja vitet e studimit (4 semestra). Planet mësimore u dërguan, por me emrat e pedagogëve vetëm për vitin e parë të studimeve, dhe konstatimi i ekspertëve ishte vetëm për vitin e parë të studimit në *mungesë të emrave të pedagogëve për vitin e dytë të studimit*. Ekspertët i qëndrojnë konstatimit të bërë (nuk iu duket e përshtatshme që ndër 10 lëndë, 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi?! ... kjo në bazë të standardeve më të mira të universiteteve në rajon e në botë).

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.1 ... Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. – Kriteri 7 ... Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. ... *Nga GVJ sugjerohet që IAL KUB të ketë më shumë marrëveshje me IAL të vendit dhe të huaja (për realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik, ashtu dhe për studentët, projekte, etj), si dhe me institucione publike & private (për realizimin e praktikës profesionale, apo për ndihmë në punimin e diplomës, etj).*

Komente nga GVB: ... KUB ka pikën më të fortë shkallën e bashkëpunimit me IAL kombëtare e ndërkombëtare, me subjektet private e publike në nivelet më të larta të mundshme. Kjo tregohet në evidencat A4.57, A1.14, A1.16 ... Numri i partnerëve të KUB është gati 2-3 fishi ... kjo konfirmohet në RVJ tuaj, standardi IV.2, kriteri 5. Çdo vit akademik KUB realizon 1-2 konferenca shkencore dhe shumica e tyre ndërkombëtare. KUB ka marrëveshje bashkëpunimi me vendet partnere ndërkombëtare me më shumë se 42 IAL perëndimore, nga të cilat 10-12 janë shumë efektive sot.

Komente nga GVJ: Në dokumentet e cituara nga IAL KUB: A1.14, A1.16, A4.57 jepen marrëveshjet me UAMD, UBT & UMT, si dhe me disa kompani të cituara në RVJ nga GVJ. Në komentin e IAL thuhet marrëveshje me 42 IAL perëndimore, marrëveshjet e të cilave ekspertët nuk i konstatojnë/gjejnë në materialet e uploaduara në sistem nga IAL ... ekzistojnë 2 dokumenta të uploaduara me të njëjtin emërtim A1.15... Lista e marrëveshjeve me IAL, njëri me 6 faqe e tjetri me 38 faqe ku jepen disa marrëveshje (në sistem konstatohen dhe në raste të tjera dublime emërtimesh për dokumentat/files që krijojnë konfuzion!). Ekspertët pjesën e marrëveshjeve [me IAL të vendit dhe të huaja, me institucione publike (për profilin Administrim Publik) dhe kompani private (për profilin Menaxhim Marketingu)] e kanë sugjerim, të cilit i qëndrojnë, duke marrë në konsideratë që është PS me dy profile: Administrim Publik dhe Menaxhim Marketingu.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.3 ... Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). – **Kriteri 1 ...** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. ... *Sipas drejtuesve të IAL KUB, për literaturën digjitale, kanë marrëveshje me JSTOR dhe QUESTIA (paraqitur faturë pagese nga IAL KUB lidhur me JSTOR) ... por sugjerohet nga GVJ që të vihet në dispozicion dhe marrëveshja/kontrata e plotë me ta.*

Komente nga GVB: Ajo që citohet është e saktë, dhe në fakt kemi dakordësinë që në atë kohë kur u zhvillua vizita e ekspertëve, u vonua marrëveshja, por që u bë testimi dhe ajo funksionon dhe për ne ishte e rëndësishme, Gjithësesi, tani është dokumenti përkatës bashkëlidhur. Nga ky dokument, bie vlerësimi 'Kryesisht' i bërë nga ekspertët.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë çfarë është vënë si evidencë. Ekspertët nuk shohin dokumentin zyrtar bashkëlidhur (siç u citua në RVJ).

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.3 ... Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). – **Kriteri 4 ...** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. ... *Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se IAL KUB ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në gjuhën shqipe dhe të huaj (sidomos të viteve të fundit) për të mbështetur nevojat e programit MSH në "Menaxhim Biznesi" me profile: "Administrim Publik" dhe "Menaxhim Marketingu*

Komente nga GVB: KUB për këtë qëllim cakton çdo vit nga buxheti i vet fondin përkatës për blerjen e librave të rinj periodikisht çdo vit akademik. Kjo ka funksionuar normalisht çdo vit. Nuk ka vend për të vendosur sugjerime për ekspertët.

Komente nga GVJ: KUB normalisht parashikon blerjen e librave të rinj çdo vit. Ekspertët mendojnë që *ka vend për të vendosur sugjerimin* lidhur me shtimin e titujve të librave në gjuhën shqipe dhe të huaj (sidomos të viteve të fundit) për të mbështetur nevojat e programit MSH në

“Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Madje, nga GVJ sugjerohet që të punësohet staf i dedikuar vetëm për bibliotekën për t’ju shërbyer sa më mirë stafit dhe studentëve (jo të kryhet ky rol nga një punonjëse nga personeli akademik!).

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.5 ... Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. – Kriteri 1 ... Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. ... GVJ sugjeron që duhej një raport më i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi.

Komente nga GVB: Kjo fushë përfaqësohet nga staf i KUB që e ka ekspertizën dhe kualifikimin më të mirë dhe të plotë të mundshëm. Jeni të lutur ta rishikoni dhe njëherë dokumentacionin në aneksin përkatës pasi plani i buxhetit dhe realizimi i tij në KUB hartohen dhe plotësohen në nivele të detajuara hollësisht për çdo njësi bazë dhe deri në nivel progamesh, njësisish kryesore dhe si institucion ... Integrohet në raportin vjetor të KUB dhe është dhe në evidencën e RVB.

Komente nga GVJ: GVB në RVB citon dokumentin A4.62, i cili përmban 3 faqe përshkrimore (GVJ ka hulumtuar dokumentat e ngarkuara dhe i ka cituar). GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë gfarë është vënë si evidencë. IAL KUB jep të dhëna financiare në nivel institucional. Asnjë nuk ka dyshime për drejtuesit e IAL KUB, por ideja është që në bazë të kërkesave të kriterit përkatës të standardit, sugjerohet që duhej një raport më i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi.

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.5 ... Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. – Kriteri 2 ... Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen

e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. ... Nga GVJ sugjerohet që duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vetë!).

Komente nga GVB: Njësoj si komentet për kriterin 1 më lart.

Komente nga GVJ: GVJ në përgjigje është bazuar te kriteri përkatës i standardit dhe atë çfarë është vënë si evidencë. Në bazë të kërkesave të kriterit përkatës të standardit, sugjerohet që duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vetë!).

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.5 ... Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. – Kriteri 3 ... Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. ... Nga GVJ sugjerohet që duhej më shumë informacion (më i plotë) mbi auditimin financiar të jashtëm të pavarur që tregon vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së financimit dhe efektivitetin financiar të LAL KUB.

Komente nga GVB: Në aneksin A6.84 të RVB është Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të KUB nga Grant Thorton, por dhe raporti vjetor i veprimtarisë akademike financiare, si pasqyrat financiare vjetore të KUB për çdo vit fiskal të KUB, të publikuara dhe në faqen zyrtare të QKB, por dhe në faqen zyrtare të KUB. Këto dokumente janë transparente e të plota.

Komente nga GVJ: Në RVB nuk është cituar qartë informacioni (nga GVB) lidhur me këtë kriter. **Komenti merret parasysh dhe reflektohet tek RVJ (tek ky kriter), por që nuk ndikon në vlerësimin e standardit IV.5.**

GVJ në FUSHA IV – Standarti IV.5 ... Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. – Kriteri 4 ... Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. ... *GVJ sugjeron që duhej raportim deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.*

Komente nga GVB: KUB e ka realizuar më mirë se çdo IAL tjetër. Buxheti i KUB zbret deri në njësinë bazë me të gjithë elementët e tij.

Komente nga GVJ: IAL KUB raporton në nivel institucional mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Në bazë të kërkesave të kriterit përkatës të standardit, GVJ sugjeron që *duhej raportim deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.*

Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.

Koment përfundimtar: GVJ është treguar shumë serioz, profesional dhe dashamirës në trajtimin, vlerësimin dhe shkrimin e RVJ.

GVJ: Prof.Asoc.Dr. Arjan Qefalia



Prof.Asoc.Dr. Gentiana Kraja



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim
Marketing”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> | <p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketingu është një program studimi i cili ofrohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Strategjinë për Arsimin e Lartë dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Programet e studimit të KUB janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të arsimit të lartë dhe planet strategjike të tij janë në përputhje me vlerat kombëtare. Në këtë kontekst Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketingu është në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Edhe pse nuk është një program që ka lidhje me fushat, programi i plotëson kriteret e këtij standardi dhe është në mbështetje të zhvillimit dhe mbrojtjes së interesave kombëtare.</p> <p><i>Evidenca</i> A1.7, A.1.11</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi në profilet Administrim Publik dhe Menaxhim është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit në përgatitjen e studentëve. Ky program studimi është dizenuar për të përgatitur studentë për një karrierë të suksesshme në sektorin Publik si dhe në menaxhimin e Marketingut por edhe në sektorin privat në nivel teknik e profesional. Thelbi i programit fokusohet në formimin e të menduarit kritik tek studentët, me aftësinë për të menduar dhe vepruar njëkohësisht si dhe për të gjykuar situata specifike.</p> <p><i>Evidenca</i> A 1.8 Dok. 3</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing është hartuar dhe iu ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të zhvillimit të Institucionit, IAL KUB. Drejtimit strategjike të zhvillimit të KUB-it shprehen në Statutin e tij dhe në Planin të Zhvillimit Strategjik të Institucionit, 2021 – 2026.</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Statuti dhe rregullorja e IAL KUB si dhe rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing përcaktojnë drejtimet prioritare akademike të institucionit dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me to. Programi Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing është hartuar për t'i ofruar studentëve përgatitjen e nevojshme në përputhje të plotë me fushën e studimit. | | |
| | <i>Evidenca</i> A 1.8, Dok. 3. | | |
| Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing bazohet në dokumentat strategjike kombëtarë dhe institucional. Plani strategjik institucional, ashtu siç shprehet është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit, pasi reflektohet në planet mësimore, programet e lëndëve. Pra, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing përputhet me përcaktimet strategjike në nivel makro dhe mikro. | | |
| | <i>Evidenca</i> A 1.8, Dok. 5. | | |
| Konkluzione | <i>KUB e ofron programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet pjesërisht |
| | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi 1.2 | |
| Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | IAL KUB dëshmon të ketë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile: Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Administrimi Publik dhe Menaxhimi i Marketingut ofrohen nga Fakulteti i Ekonomisë i cili ka një eksperiencë relativisht të mirë në |

| | |
|--|--|
| | <p>ofrimin e programeve të këtyre fushave. IAL KUB dhe Fakulteti i Ekonomisë dëshmojnë të kenë kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të mjaftueshme për ofrimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca</i> A 1.10</p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, Fakultetit të Ekonomisë përgjegjës për këtë program, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><i>Evidenca</i> A 1.11, Dok. 4.</p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile: Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit të Fakultetit të Ekonomisë të IAL KUB. Në këtë kontekst fusha e përgjithshme dhe fusha specifike e programit të studimit përputhen me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë dhe njësisë kryesore nga të cilat ofrohet dhe administrohet programi i studimit.</p> <p><i>Evidenca</i> Dok.3 neni 3 pika 3,4,5.</p> |
| <p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p> | N/A |
| <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> | <p>IAL KUB bën përpjekje të vazhdueshme në aktualizimin e njohurive të studentëve ndërmjet ofrimit të trajnimve profesionale ndërmjet marrëveshjeve me aktorë në fusha të ndryshme të ekonomisë, leksioneve të hapura me personalitete të shquara të ekonomisë të sektorit publik dhe atij privat. Struktura e krijuar pranë KUB “Instituti për Studime dhe Aplikime Biznesi” realizon arsimin, e trajnime të vazhduar përmes kurseve afat shkurtër për përditësimin e njohurive të kapaciteteve dhe ekspertizës profesionale.</p> <p><i>Evidenca</i> A 1.12</p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i></p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------------|-----------------------|
| | | X |

| Standardi I.3 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>IAL KUB ka krijuar ambientet e nevojshme për zhvillimin profesional dhe bashkëpunimin. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të KUB, në zbatim të VKM dhe në Udhezimin e MASH për organizimin e programeve të studimit. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, pesha kryesore e njësisë bazë që është Departamentit i Menazhimit siguron realizimin sasior dhe kontrollin cilësor të zhvillimit të programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca</i> A 1.13</p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p> | <p>IAL KUB në kuadër të implemtimit të objektivave dhe strategjisë për zhvillimin institucional ka bërë përpjekjet e duhura për mundësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në plan kombëtar dhe ndërkombëtar. KUB ka marrëveshje me IAL publike si UBT dhe UAMD, me biznese private si dhe në kuadër të programit Erasmus+ numëron rreth 43 marrëveshje, si për shembull Universiteti Cadiz, Spanjë, University Kodolany Hungari, Mugla Sitiki Kocman University Turqi, Masia SS Assunta Itali, Alanya University Turqi, etj. Marrëveshjet janë realizuar në kuadër të aktualizimit dhe profesionalizimit të studentëve si dhe në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit.</p> <p><i>Evidenca</i> A 1.14, A 1.15 www://kub.edu.al/?s=marrevshje+bashkepunimi</p> |
| <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e</p> | <p>IAL KUB në funksion të realizueshmërisë së objektivave të programit të studimit ka mundur marrëveshje për të realizuar praktikat profesionale nga studnetët. Këto marrëveshje janë realizuar me biznese, me bankat e nivelit të dytë, kompani sigurimi, institucione publike të qeverisjes vendore dhe qendrore, kompani auditimi etj.</p> <p>Procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces (Udhëzuesi i praktikave). Raporti i Praktikës nënshkruhet dhe vulozet nga Institucioni përkatës publik.</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|--|
| kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | <i>Evidenca</i> <i>A 1.16, A6.85</i> | | |
| Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | IAL KUB dhe Fakulteti i Ekonomisë hartojnë analizën vjetore e cila evidenton ecurinë e performancës akademike dhe mësimore të programit të studimit. Gjithashtu, njësitë kryesore periodikisht raportojnë pranë senatit akademik të KUB lidhur me ecurinë e bashkëpunimeve me partnerët alternativ. Në këtë kuadër analizohet edhe ecuria e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit. | | |
| | <i>Evidenca</i> <i>A1.17</i> | | |
| Konkluzione | <i>KUB siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|--|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |
|---|--|-----------------------------|--|

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| Standardi II.1 | |
|---|---|
| Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me Udhëzimin 31 të MASR, si dhe VKM nr.41 me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Programi zhvillohet në 2 vite akademike, me mundësi transferimi kreditesh sipas standardeve Evropiane. Lëndët e këtij programi studimi sipas të dy profileve janë ndarë në këtë mënyrë që në Semestrin e I dhe të II të vitit të parë zhvillohen 5 lëndë me nga 6 kredite për semester si dhe në Semestrin e I të vitit të dytë, zhvillohen 5 lëndë me nga 6 kredite, (ECTS). Në semestrin e dytë të vitit të dytë, praktikë dhe stazh me 12 kredite, ndërsa punimi i diplomës është vlerësuara me 18 kredite, duke bërë që në total ky master të këtë 120 ECTS. Kreditet e programit të studimit për të dy profilet janë të organizuara si vijon: Kategoria A e organizuar sipas 12 krediteve, kategoria B e organizuar sipas 60 krediteve, kategoria C e organizuar sipas 18 krediteve, kategoria D e organizuar sipas 12 krediteve, kategoria E e organizuar sipas 18 krediteve.</p> <p><i>Evidenca</i> A 2.19</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Programi i studimit në formimin e kurrikulave, në shtrimin e objektivave si dhe me strukturën akademike si dhe procedurat ndërmjet të cilave operon, i shërben formimit të studentëve sipas dy profileve të këtij programi Administrim Publik dhe Menaxhim Marketingu. Kompetecat profesionale dhe akademike janë të mundësuar jo vetën nga përmbajtja e programit të studimit por edhe nga forma dhe metodologjia me të cilën ai ofrohet duke ju referuar organizimit të orës mësimore, detyrave individuale apo në grup, praktikë profesionale, realizueshmërisë së tezës së diplomës etj. Këto elemente të ofrimit të programit të studimit janë të përcaktuara edhe në rregulloren e programit të studimit. <i>Duke iu referuar përbërjes së kurrikulave sipas disiplinave përkatëse si edhe syllabuseve të lëndëve rekomandohet që të përshtaten më mirë me ciklin në të cilin ofrohen ashtu si edhe me profilin përkatës.</i></p> <p><i>Evidenca</i> A 2.18, A 2.23,</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing si në planin mesimor ashtu edhe në kurrikulat ka të përcaktuar mirë ngarkesat mësimore sipas</p> |

| | |
|---|---|
| <p>profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>disiplinave dhe sipas kategorive të lëndëve, sipas viteve akademike dhe sipas semestrave respektiv. Gjithashtu në kurrikulat e programit të studimit përcaktohen kreditet dhe modalitetet përkatëse të praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse. Realizimi i detyrimeve përmbyllëse organizohet sipas një procedure të përcaktuar edhe në rregulloren e programit të studimit. Në këtë program studimi praktikat profesionale organizohen sipas 12 krediteve dhe diploma në 18 kredite.</p> <p><i>Evidenca</i> A 2.19, A2.20.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p> | <p>N/A / Ky program studimi nuk është një program i fushës së mësuesisë.</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p> | <p>N/A / Ky program studimi nuk është një program i fushës së mësuesisë.</p> |
| <p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>N/A – Institucioni nuk ka status të veçantë.</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing ofrohet në përputhje me kriterin e ngjashmërisë në përmbajtje me programet analoge me të njëjtën emërtesë.</p> | | |
| <p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing është kodifikuar duke u bazuar tek kërkesat e MAS.</p> | | |
| <p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> | <p>N/A</p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, gjithsesi ka vend për të përmirësuar. Duke iu referuar përbërjes së kurrikulave sipas disiplinave përkatëse si edhe syllabuseve të lëndëve rekomandohet që të përshtaten më mirë me ciklin në të cilin ofrohen ashtu si edhe me profilin përkatës. Ky kriter përmbushet kryesisht.</i></p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> |
| | | <p>X</p> | |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e</p> | <p>Departamenti i Menaxhimit të Fakultetit të Ekonomisë realizon kriteret ligjore për administrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim</p> |

| përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Marketing. Ky departament/fakultet në zbatim të bazës ligjore ka krijuar instrumentat e duhur akademik të realizojë programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing sipas përcaktimeve përkatëse mbi bazën e të cilave është hapur si program. Personeli akademik në funksion të programit është sipas kërkesave të përcaktuara. <i>Evidenca</i> A2.21 | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Njësia kryesore ka kapacitete njerëzore të cilat i angazhon në realizimin e proceseve mësimore si dhe disiplinave respektive të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. <i>Evidenca</i> A1.10 | | | | | | |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Departamenti i Menaxhimit ka përcaktuar koordinatorin si dhe drejtuesin e praktikës. Gjithashtu është përcaktuar edhe një personel akademik në funksionin e “tutorit” të orarit mësimor. <i>Evidenca</i> Urdhër i rektorit nr. 14 datë 29.12.2022 | | | | | | |
| Konkluzione | <i>Njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë dhe njësia bazë përgjegjëse Departamenti i Menaxhimit për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i> | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

Standardi IL3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe

Dokumentacioni për strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing, administrohet nga Departamenti i Menaxhimit si njësi bazë kërkimore shkencore të

| | |
|--|--|
| përmbajtjen e programit të studimit. | Fakultetit të Ekonomisë. Njësia bazë dhe njësia kryesore disponojnë kurrikulat, planet mësimore, rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e njësive ndërmjet të cilave administrohet programi i studimit. <i>Evidenca</i> A 2.22, Dok 2. |
| Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing pasqyron informacionin në lidhje me shpërndarjen e lëndëve dhe moduleve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor, orët jashtë auditorit/studimit individual të studentit. <i>Rekomandohet që plani mësimor dhe kurrikula të pasqyrojnë klasifikimin në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje: kjo ndarje mungon, lëndët me zgjedhje mungojnë.</i> <i>Evidenca</i> A.23, Dok 2 |
| Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit e ekuivalentimit të studimeve. Kriteret për pranimin e studentëve që ndjekin IAL KUB për këtë program studimi janë të pasqyruara në Rregulloren përkatëse të KUB dhe të Departamentit të Menaxhimit, po ashtu edhe procesi i ekuivalentimit nga IAL të tjera drejt KUB dhe anasjelltas. <i>Evidenca</i> A 2.24, Dok 18. |
| Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programet e lëndëve janë subjekt rishikimi para çdo viti akademik me qëllim përditësimin e tyre. Në program gjendet informacioni në lidhje me objektivat e lëndës, temat e lëndës, format e kontrollit të dijeve dhe mënyra e vlerësimit. Në fillim të çdo viti plotësohet për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing dosja e cila përmban kurrikulën, planet mësimore, ngarkesën e stafit akademik, syllabuset etj. <i>Evidenca</i> A2.25 |
| Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing përditësohet periodikisht në fillim të çdo viti duke ju përshtatur ndryshimeve që vijnë si propozime të njësive si dhe duke ju përshtatur ndryshimeve të tregut. <i>Evidenca</i> A 2.26 |
| Konkluzione | <i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të</i> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>programit të ciklit të dytë. Rekomandohet që plani mësimor dhe kurrikula të pasqyrojnë klasifikimin në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje: kjo ndarje mungon, lëndët me zgjedhje mungojnë. Ky kriter përmbushet kryesisht.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | X | |

| Standardi II.4 | |
|--|---|
| Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Përmbajtja e programeve të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe shembujt praktike të trajtuar gjatë të gjithë ciklit të studimit, mundësojnë për studentët e IAL KUB, Fakulteti i Ekonomisë, thellim të njohurive dhe aftësive të tyre në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Programi Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale, mundëson punësimin e të diplomuarve në mënyrë të veçantë edhe në përputhje me emërtimin e tij në sektorin publik, dhe atë privat, në fushën e marketingut gjithashtu konform Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë”. <i>Evidenca</i> A 2.27 |
| Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing, është hartuar në bazë të Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të studimeve, është organizuar të ketë shtrirje përgjatë 4 semestrave me kohëzgjatje normale 15 javë. Ndërtimi i kurrikulave harmonizon disiplinat me objektivat formuese në funksion të aftësive profesionale të studentëve. <i>Evidenca</i> A2., 26, 27 |
| Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të | Në strukturën e programit të studimit evidentohen objektivat formuese të studimit të cilat janë në përputhje me përcaktimet ligjore. Lëndët që ky program studimi përmban janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit. Ngarkesa mësimore për këtë program studimi është 3,000 orë mësimore me një total (120 ECTS), duke e përafëruar këtë program studimi me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kurrikulat sigurojnë mobilitet i cili reflektohet në bashkëpunimin në kuadër të Erasmus +. |

| | |
|---|---|
| sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | <i>Evidenca</i> Master Profesional NA |
| Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing garanton pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në lidhje me metodat, teknikat dhe instrumentat që u vijnë në ndihmë për të arritur objektivat e synuara të programit të studimit. Veprimtaritë formuese në këtë program studimi mundësojnë transferimin e studimeve, mobilitetet dhe punësimin në përfundim të studimeve. <i>Evidenca</i> A 1.35, A 1.17, Dok 10. |
| Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Fakulteti i Ekonomisë/Departamenti i Menaxhimit, personeli akademik i tij përmirëson vazhdimisht syllabuset. Syllabuset përgatiten duke respektuar formatin tip dhe lirinë akademike. Syllabuset janë të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që studentët të përvetësojnë njohuritë e nevojshme nga secila lëndë e zhvilluar në këtë program studimi, në përshtatje me tregun e punës. <i>Evidenca</i> A3.36, A2.25, A4.64, Dok 23. |
| Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Në përputhje me objektivat për programet e studimit të ciklit të dytë, programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara shkencore teorike e praktike. Ky program studimi i cili ka synim që të përgatisë specialistë të lartë të aftë për administratën publike, si dhe në Menaxhim marketing është i hartuar në mënyrë të tillë që i krijon mundësi studentëve të regjistruar të përfitojnë dijet, aftësitë dhe kompetencat e thelluara të nevojshme për të hyrë në tregun e punës. <i>Evidenca</i> A 2.20. |
| Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Departamenti i Menaxhimit, ka mundësuar që përmes përmbajtjes së programeve të studimit studentët të kenë mundësi të vijimësisë së studimeve. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me partnerët, nxitet dhe mundësohet punësimi i tyre duke iu përshtatur nevojave të tregut. Përmbajtja e programit të studimit mundëson integrimin e praktikës me teorinë. Niveli i punësimit të këtij programi tregon se ai është në përputhje me kërkesat e tregut, si dhe përmbajtja e tij dëshmon për plotësimin e dijeve të studentëve. <i>Evidenca</i> A2.27, A 5.67 |

| | | | |
|--|---|----------------------|-----------------------|
| Konkluzione | <i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi IL5 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Për përshtatjen e mirë të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse të KUB marrin në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve si Konfindustria, Bashkimi i Prodhuesve Shqipëtarë, Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë, Instituti i Audituesve Ligjorë, Studiot e Shërbimeve Ekonomike Profesionale, etj. Ecuria e programeve të studimit ndiqet nga departamenti dhe fakulteti duke përfshirë edhe mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës si dhe feedback-un nga studentët. <i>Evidenca</i> A1.16 |
| Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | IAL KUB përfshin studentët në vendimarrjen dhe në çështje madhore të institucionit. Studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse dhe kolegjiale të KUB, si Senati Akademik si dhe janë pjesë aktive e diskutimeve. Mbahen lidhje me studentët e diplomuar. Feedback-u dhe informacioni që vjen nga studentët pjesë e ALUMNI si dhe partnerët me të cilët KUB ka marrëveshje bashkëpunimi ku studentët realizojnë edhe praktikatat profesionale, është një burimim nga i cili KUB realizon përmirësimin në programet e studimit dhe kurrikulat. <i>Evidenca</i> A4.57, A5.75, Dok 10. |
| Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete | Departamenti i Menaxhimit në bashkëpunim me partnerët realizon përmirësime në programin e studimit dhe në syllabuset respektive. Departamenti vjel ide dhe nevoja konkrete nga ana e këtyre institucioneve në mënyrë që të përshtasë programet studimore sa më shumë të jetë e mundur me nevojat konkrete të administratës publike, në nivel qëndror |

| | | | | | | | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|--|--|--|----------|
| profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | dhe nivel lokal. Eksperiancat me universitetet perendimore japin një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e programit dhe në sigurimin e mobilitetit të tij. | | | | | | | | |
| | <i>Evidenca</i> Dok 10 | | | | | | | | |
| Konkluzione | <i>IAL KUB nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i> | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| Standardi II.6 | |
|--|--|
| Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | <p>Në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing janë përcaktuar qartë objektivat të cilat synohen të arrihen për studentët. Objektivat dhe qëllimet e programit të studimit janë në përputhje dhe mbështeten mbi qëllimet madhore të universitetit për të përgatitur specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar e ndërkombëtar të punës si edhe të formojë kërkues shkencorë nëpërmjet punës kërkimore/shkencore të nivelit bashkëkohor. Janë bërë përpjekje për ndërkombëtarizimin e programit të studimit ndërmjet programit Erasmus +, <i>ndonëse duket se nuk ka patur një interes të madh nga ana e studentëve.</i> Objektivi i ndërkombëtarizimit është ndër objektivat e KUB të planit strategjik të 2021 – 2026. <i>Rekomandohet të shtohen përpjekjet dhe incentivimi i studentëve të këtij programi në shfrytëzimin e mundësive Erasmus + në kuadër të ndërkombëtarizimit.</i></p> <p><i>Evidenca</i> A 2.28 Dok 3.</p> |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | <p>Njësia Kryesore/Njësia Bazë referuar Statutit të IAL KUB dhe Rregulloreve respektive nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik. Fakulteti dhe Departamenti suportojnë veprimarinë e personelit akademik në kuadër të mësimdhënies të kërkimit shkencor dhe në veprimtaritë që ndërmarrin me studentët si dhe bashkëpunojnë me qevrinë studentore. Në kuadër të bashkëpunimit personela akademik – student është zhvilluar konkursi “Projekti im fillon këtu”.</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Evidenca</i> A 2.29 | | |
| Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing e realizon veprimtarinë mësimore nëpërmjet leksioneve, seminareve, ushtrimeve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, praktikës. Për nga vetë mënyra se si operon programi i studimit nxit studentët në anagaxhimin në projekte të ndryshme. Studentët gjithashtu nxiten të marrin pjesë kë konferenca shkencore. | | |
| | <i>Evidenca</i> A2.30 | | |
| Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga IAL KUB. KUB zhvillon aktivitet me karakter kërkimor shkencor, tavolina të rrumbullakëta të cilat i shërbejnë aspektit akademik, kërkimit shkencor dhe projekteve. KUB mbështet financiarisht personelin akademik në kërkimin shkencor. KUB mbështet financiarisht organizimin e aktiviteteve shkencore ndër të cilat edhe konferencat shkencore. | | |
| | <i>Evidenca</i> A 2.31 | | |
| Konkluzione | <i>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Gjithesesi meqënëse orientim dhe prioritet i institucionit është edhe ndërkombëtarizimi, rekomandohet të shtohen përpjekjet dhe incentivimi i studentëve të këtij programi në shfrytëzimin e mundësive Erasmus + në kuadër të ndërkombëtarizimit.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | X | |

| | |
|--|---|
| Standardi II.7 | |
| Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | IAL KUB, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhimit bashkërendojnë dhe mbështetin aktivitetin e kërkimit shkencor të personelit akademik. Personeli akademik incentivohet në realizimin e botimeve në revista me SCOPUS dhe me faktor impakti. Aktualisht sipas këtij dimensionit ka një rankim të mirë në shkallë vendi. <i>Evidenca</i> A 2.32 |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> | <p>IAL KUB ka një zyrë të kërkimit shkencor dhe projekteve e cila angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e objektivave. Në këtë kontekst kjo zyre ka qene produktive me studentët e ciklit të parë të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><i>Evidenca</i> A 2.33</p> |
| <p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p> | <p>Në aktivitetin e tij shkencor, IAL KUB i ka dhënë një rëndësi të mjaftueshme tematikave të lidhura me fushat prioritare të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Organizimi i aktiviteteve shkencore si konferencat apo botimet lidhur me menaxhimin e marketingut dhe administrimin publik kanë qenë prioritet i aktivitetit shkencor të KUB.</p> <p><i>Evidenca</i> A 2.34.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p> | <p>Studentët të cilët e mbyllin me sukses programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing mund të punësohen në sektorin publik dhe në atë privat si specialistë dhe ekspertë të sektorëve të menaxhimit dhe marketingut. Programi i studimit mundeson formimin e profesionistëve të aftë për tu punësuar në fushat e menaxhimit dhe marketingut, në sektorin publik dhe atë privat.</p> <p><i>Evidenca</i> A 5.69 Treguesit e Punësimit.</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p> | <p>IAL KUB bashkëpunon me subjekte të ndryshme për të realizuar aktivitete të përbashkëta. Gjithashtu KUB ka fituar të drejtën për të kryer trajnime dhe kualifikime me profesionistë të fushës të cilët duhet të realizojnë edukimin e vazhduar për të fituar titullin profesional Kontabilist i Miratuar ose Auditues Ligjor. Ndërmarrja në keto procese dhe bashkëpunime ka bërë që KUB të ketë informacionin e nevojshëm lidhur me urdhrat, shoqata profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e duhura në rregullimin ligjor të profesioneve përaktëse të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca</i> A 2.35</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të</p> | <p>Programi i studimit nuk bën pjesë tek profesionet e rregulluara, por krijon premisa për kualifikime të thelluara në fushën e marketingut, administrimit publik dhe menaxhimit të institucioneve publike e private. Studentët e suksesshem të programit Menaxhim Biznesi mund të</p> |

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU). | konkurojnë për fitimin e titullit Kontablisit i Miratuar apo Auditues Ligjor. | | |
| | Evidenca A 2.35 | | |
| Konkluzione | Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Ky kriter përmbushet plotësisht. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | | | |
|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | IAL KUB përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies. Aktualisht për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing integrohen dy metoda të mesimdhënies: aspekti teorik ku përfshihen leksionet dhe aspekti praktik ku përfshihen seminarët detyrat e kursit etj. Nga KUB motivohet puna në menyrë të pavarur e studentit. Në syllabus evidentohen format e miratuara të mesimdhënies nga KUB. Evidenca A 3.36 |
| Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Realizimi i programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing ka në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizuar në mënyrë të suksesshme mësimdhënien. Mjediset në të cilat zhvillohet mësimi janë të pajisura me mjetet e duhura për zhvillimin normal të mësimin. Personeli akademik sipas rastit përdor mjete alternative për të |

| | |
|---|---|
| | <p>realizuar një mësimdhënie sa më efektive dhe në funksion të objektivave të programit të studimit. Një shembull i mirë është edhe përshtatja e menjëhershme e KUB me situatën e mësimdhënies online gjatë pandemisë.</p> <p><i>Evidenca</i> A3.37, A 3.43</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> | <p>IAL KUB mundëson përmirësimin e formimit të personelit akademik duke ju ofruar mundësi trajnimi dhe kualifikimi brenda institucionit por edhe nga institucione të tjera. ISAB e ngritur brenda KUB ndihmon në procesin e përmirësimit akademik dhe kërkimor të personelit akademik. Nga KUB realizohen gjithashtu seanca trajnimi periodike mes personelit akademik dhe studentëve në funksion të efikasitetit të procesit të mesimdhënies.</p> <p><i>Evidenca</i> A 3.38, A3.43</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>IAL KUB në politikat e tij të përzgjedhjes së personelit akademik promovon përfshirjen e lektorëve me titujt dhe gradat respektive për tu përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Gjithashtu KUB përpiqet të bëjë pjesë të institucionit brezin e specialistëve të shkolluar në vendet perëndimore duke i dhënë një mundësi më shumë eksperiencave bashkëkohore të mësimdhënies të bëhen pjesë e institucionit dhe e praktikave që ai përdor dhe adapton për të administruar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Suksesi i këtyre procesve reflektohet edhe në vlerësimet e studentëve si pjesë e vlerësimit të mësimdhënies. Sipas rastit KUB realizon trajnime kur është e nevojshme për të ndihmuar në këtë proces si dhe për të ndihmuar në adaptimin e teknikave inovative. Metodatat e mesimdhënies dhe të kontrollit të dijeve janë të pasqyruara në syllabuset repektive të miratura nga departamenti përkatës.</p> <p><i>Evidenca</i> A 5.67, A6.79, Dok 7.</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Departamenti i Menaxhimit si pjesë integrale e Fakultetit të Ekonomisë administron programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing në drejtim të veprimtarisë akademike, kërkimore shkencore dhe administrative. Njësia kryesore dhe njësia bazë janë përgjegjëse të për menaxhimin e cilësisë së programit të studimit. Drejtuesi i njësisë kryesore kontrollon cilësinë e procesit mësimor. Bazuar në feedbackun e marrë nga instrumenta të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë realizohet edhe procesi i përmirësimit të performancës.</p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|-----------------------------------|
| | <i>Evidenca</i> A1.17, Dok 4 dhe Dok.10 | | |
| Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | IAL KUB mundëson përmirësimin e formimit të personelit akademik duke ju ofruar mundësi trajnimi dhe kualifikimi brenda institucionit por edhe nga institucione të tjera. ISAB e ngritur brenda KUB ndihmon në procesin e përmirësimit akademik dhe kërkimor të personelit akademik. Nga KUB realizohen gjithashtu seanca trajnimi periodike mes personelit akademik dhe studentëve në funksion të efikasitetit të procesit të mesimdhënies. KUB gjithashtu ka institucionalizuar Komisionin e Promovimit të personelit Akademik. | | |
| Konkluzione | <i>Evidenca</i> A 3.38, A3.43 | | |
| Konkluzione | IAL KUB garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Ky kriter përmbushet plotësisht. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |

| | |
|---|--|
| Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Mënyrat e kontrollit të dijeve dhe testimit të njohurive dhe aftësive profesionale për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing janë të pëcaktuara qartë në Rregulloren e Njësisë bazë dhe asaj kryesore ashtu siç edhe në rregulloren e programit të studimit. Pëveç fromave klasike në këtë program studimi vlerësohet edhe aktivizimi, detyrat e kursit, projektet, testimet etj. |
| | <i>Evidenca</i> A3.40, Dok 3, Dok 13. |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të | Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing në programet e lëndëve dhe disiplinave respektive përcakton qartë mënyrat e vlerësimit si planin mësimor të çdo lënde. Ky informacion i bëhet i ditur studentit që në orën e parë të lëndës përkatëse nga personeli akademik i |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | angazhuar në mësimdhënien e asaj lënde, shpërndarja e këtij informacioni realizohet edhe nga pedagogu tutor. Programet e lëndëve janë të publikuara edhe në portalin e KUB në sitin personal të pedagogëve. Pra, studentëve u prezantohet struktura e lëndëve dhe përqindjet e pikëve për të gjithë elementët. | | |
| | <i>Evidenca</i> A3.40 Dok 13. | | |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Studentët në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing vlerësohen ndërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, rasteve të studimit dhe provimit përfundimtar. Siç u shprehem më lart, mënyra e vlerësimit është e shprehur në syllabusin e lëndës dhe u bëhet e ditur studentëve. Vlerësimi i vazhduar zë një peshë specifike prej 40% të vlerësimit total të studentit gjë që incentivon përgatitje sistematike, të pavarur dhe kreative të studentit. | | |
| | <i>Evidenca</i> A3.41, Dok 13. | | |
| Konkluzione | <i>KUB harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi III.3 | |
| Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Format e vlerësimit nga ana cilësore dhe sasiore përcaktohen qartë në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, të Departamentit të Menaxhimit si dhe të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Pedagogu i lëndës realizon vlerësimin e studentit mbi njohuritë dhe dijet e fituara sistematikisht dhe ky vlerësim përfshihet në vlerësimin përfundimtar. |
| | <i>Evidenca</i> A3.42 |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të | Gjatë periudhës së pandemisë kanë gjetur zbatim sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit ku është përfshirë edhe kontrolli i dijeve. Përmes tyre dhe portalit të KUB pedagogët kanë zhvilluar elektronikisht |

| | |
|--|--|
| <p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>testimet e ndërmjetme të lëndës dhe detyrat ekursit që kanë rezultuar si një formë mjaft e sukseshme e testimit të njohurive.</p> <p><i>Evidenca</i> A 2.36 Dok 13.</p> |
| <p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> | <p>Format e vlerësimit përfundimtar të lëndës mirepërcaktohen në instrumentat ligjorë dhe syllabuset për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing dhe vlerësimi përfundimtar realizohet mbi bazën ligjore dhe në përputhje me syllabusin.</p> <p><i>Evidenca</i> Dok 13</p> |
| <p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive realizohet nga pedagogu i lëndës i cili vlerësimin e tij e shoqëron dhe me komentet respektive sipas rastit, vlerësimi dhe komentet respektive realizohen nga pedagogu për çdo pyetje deri në arrijten e një vlerësimi përfundimtar. Pedagogu i lëndës ndërmjet ballafaqimit të rezultateve të procesit të vlerësimit duke përfshirë të gjithë elementët e vlerësimit të njohurive bën transparent rezultatet e studentit, përmirësimet që duhet të bëjë dhe rezultatin përfundimtar.</p> <p><i>Evidenca</i> Dok 13.</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> | <p>KUB në rregulloren e tij, Statutin, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e Departamentit të Menaxhimit si dhe rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing përcaktohet kuadri ligjor i shmangjes së plagjiaturës/ kopjimit në detyra dhe provime. Nga ana operative ky proces sipas rastit ndiqet nga pedagogu i lëndës, bashkëpunuesve në provim apo komisioneve.</p> <p><i>Evidenca</i> A 3.43 dhe Dok 13.</p> |
| <p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Nga IAL KUB janë krijuar instrumentat ligjorë dhe praktike për të vlerësuar me meritokraci dhe drejtësi dijet dhe aftësitë profesionale të studentit të programit të studimeve Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Ky proces mbikqyret nga të gjitha hallkat akademike dhe administrative të njësisë përkatëse. Studenti ka të drejtë të sqarohet për paqartësitë që ka lidhur me vlerësimin e tij ashtu siç edhe ka të drejtë të ankimojë rezultatin.</p> <p><i>Evidenca</i></p> |

| | Dok 13. | | | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | IAL KUB garanton të drejtën e ankimimit ndërmjet bazës ligjore në fuqi më specifikuisht ndërmjet rregullores së pëgjithëshme të KUB Neni 93 dhe 96 "Ankimimi i studentëve". <i>Evidenca</i> A 3.45 | | | | | | |
| Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Sipas rregullores studenti ka të drejtë të ankimojë vlerësimet e bëra në adresë të tij. Ankimimet dhe kontestimet e rezultateve depozitohen në sekretarinë mesimore e cila më pas i përcjell për administrim në departamentin përkatës. Ankimimet administrohen nga pedagogu përkatës i departamentit i cili shqyrton kërkesat dhe i komunikon sekretarisë dhe rezultatin e rivlerësimit. Në rastet e riankimimit departamenti ngre komision për rishqyrtimin e kërkesave. <i>Evidenca</i> Dok 13. | | | | | | |
| Konkluzione | <i>KUB siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Ky kriter përmbushet plotësisht</i> | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| Standardi III.4 | |
|---|---|
| Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Prgrami i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing është ndërtuar në mënyrë të tillë që respekton ndarjen ndërmjet kategorive të lëndëve si dhe për nga përmbajtja mundëson një formim i cili garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të përgjithshme dhe specifike shkencore të studentëve. Procesi i plotësimit të njohurive realizohet edhe nga trajnimet e ofruara ISAB. <i>Evidenca</i> A 1.33 |
| Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Pjesë integrale e kurrikulave të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing janë edhe disiplina të tilla si Etika, Sjellja organizative, Qeverisja e korporatave që ndihmojnë në rritjen profesionale por edhe krijimin e një backgroundi human social dhe komunikativ. |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> | <p>Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing respekton parashikimet e paraqitura në syllabus. Në këtë proces personeli akademik monitoron realizueshmerine me sukses të objektivave të lëndës si dhe planifikimeve të programit të lëndës.</p> <p><i>Evidenca</i> Dok 13</p> |
| <p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>IAL KUB ndërmjet konceptimit dhe metodologjisë së hartimit të programeve të lëndës si dhe monitorimit strukturor të këtij procesi ka mundësuar realizimin e mesimdhënies në bazë të kompetencave që duhen fituar konkretisht në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Ky synim i institucionalizuar i syllabusit konkretizohet dhe në punën e personelit akademik në materializimin e syllabusit në punën që realizojnë gjatë mësimdhënies me studentët. Në syllabuset respektive të programit të studimit por edhe në rregulloret respektive promovohet krijimi i klimës së përshtatshme, ndërthurja e formave të mësimdhënies etj.</p> <p><i>Evidenca</i> A1.16,A1.15, Dok 2.</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Nga strukturat e IAL KUB në bashkëpunim me studentët realizohen evente të cilat anagazhojnë personelin akademik dhe studentet në aktivitete të tilla kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, trajnime, workshope, leksione të hapura etj.</p> <p><i>Evidenca</i> A5.67, A4.53</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p> | <p>IAL KUB nxit dhe incentivon zhvillimin e ideve të reja dhe inovative të studentëve dhe i mbështet ato. Konferncat studentore të organizuara nga KUB duke përfshire edhe programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing si dhe konkursi “Kërkimi im fillon këtu” janë një shembull i iniciativave të institucionit në mobilizimin e studentëve.</p> <p><i>Evidenca</i> A2.33</p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p> | <p>Detyrimet përmblyëse të studentit të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing realizohen duke u bazuar tek rregullorja e përgjithshme institucionale. Guida studentore gjithashtu jep një informacion të mjaftueshëm lidhur me procedurat e diplomimit.</p> <p><i>Evidenca</i> A3.46, Dok 14, A5.58</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblyëse.</p> | <p>Detyrimet përmblyëse përcaktohen në rregulloret përkatëse, studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing marrin informacionin e nevojshëm nga strukturat akademike, administrative dhe ndihmës akademike të IAL KUB.</p> <p><i>Evidenca</i> A3.47 Dok 13</p> |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Parashikimet ligjore lidhur me komisionin e provimit final/diplomimit janë të përcaktuara nga KUB; komisioni përbëhet nga 3 anëtarë të cilët janë personel akademik me kohë të plotë i departamentit të Menaxhimit për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Gjatë realizimit të procedurës studenti ka mundësi të prezantojë punën e tij si ta mbrojtë atë para komisionit.</p> <p><i>Evidenca</i> A3.41</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse</p> | <p>Për të përcaktuar proceduralisht procesin e diplomimit për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing KUB ka krijuar "Udhëzuesin për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomes". Për çdo diplomant përcaktohet një udhëheqës i cili asiston studentin dhe raporton ecurinë e tij. Në rastet e pranimit të diplomës nga udhëheqësi studenti procedon me diplomimin.</p> <p><i>Evidenca</i> A3.47</p> |

| | |
|--|---|
| punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Struktura te akademike, ndihmes akademike dhe administratve të KUB pajisin studentin e programit të studimit të Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing me materialet e domosdoshme per realizimin e praktikave profesionale dhe diplomimit si dhe asiston studentët në realizueshmërinë praktike të temës së diplomës.</p> <p><i>Evidenca</i> A3.47</p> |
| <p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p> | <p>Siç u përmend edhe më lart procedura e diplomimit në IAL KUB është parashikuar të realizohet me mbrojtje para një komisioni të ngritur nga Rektori me propozim të Dekanit i cili përbëhet nga 3 anëtarë. Në përfundim të procesit komisioni vlerëson me notë studentin.</p> <p><i>Evidenca</i> A 3.41 A3.46</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>IAL KUB në përfundim të studimeve në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing pajis studentët me diplomë dhe suplementin përkatës të programit të studimit. Studentë mund të pajisen edhe me materiale të tjera të programit të studimit të tilla si syllabuset e lëndëve të realizuara.</p> <p><i>Evidenca</i> Dok 14</p> |
| <p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> | <p>Sekretaria mësimore e IAL KUB ruan dhe administron dokumentacionin e studentit të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing. Kur studentit diplomohet/transferohet apo ç'regjistrohet dosja e tij arkivohet. KUB arkivon dokumentacionin respektiv bazuar në Ligjin nr.9154 date 06.11.2003 "Per arkivat" si dhe rregulloren e brendshme per funksionimin e arkivit te KUB. Studenti ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar lidhur me studimet e tij dhe këto i vihen ne dispozicion nga KUB.</p> <p><i>Evidenca</i> Dok 13 dhe Dok 14</p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>IAL KUB ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi me profile Administrim Publik dhe Menaxhim Marketing dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|--|--|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

| Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve. | | | | |
|---|------------------------|--|----------------------|-----------------------|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | |
| Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | N/A | | | |
| Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | N/A | | | |
| Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalenohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | N/A | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|--|--|----------------------|-----------------------|
| | | | | |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1 | |
|---|--|
| Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> | <p>Personeli akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), personeli ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi, përvoja e përket gradave e titujve shkencorë, si dhe kualifikimeve të vazhdueshme të personelit akademik (duke marrë pjesë në mobilitete mësimdhënieje dhe trajnimi Erasmus+, etj). Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në Statutin e Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB), si dhe në Rregulloret e KUB, dhe janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë. Për realizimin e programit mësimor, specifikisht për vitin akademik 2021 – 2022 & 2022 – 2023, departamenti përgjegjës angazhoi personel akademik jo vetëm të vetë departamentit, por bashkëpunoi edhe me departamente të tjera. Departamenti i Menaxhimit përbëhet nga 7 pedagogë (si PAE) ku 3 pedagogë mbajnë gradën shkencore Dr, dhe 4 janë me master. Gjatë vitit 2022 – 2023 për realizimin e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” janë angazhuar pedagogë me grada e tituj shkencorë, si dhe me raportin e duhur PAE/PAK ... për vitin e parë të çdo profili, raporti PAE/PAK është 80% me 20%. Por, konstatohet që në vitin e parë të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik”, 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi, dhe në vitin e parë të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Menaxhim Marketingu”, 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi. Sugjerohet në të ardhmen që të ketë angazhim dhe të pedagogëve/profesionistëve të tjerë, ekspertë të fushës, kjo në interes reciprok të IAL dhe studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i> A4.48 & A4.49. Stafit Akademik i Departamentit lendet e modulet.pdf A4.50. Statuti KUB neni 41-53 Rregullorja e marrëdhënies se punes procedurat e rekrutimit dhe perzgjedhjes neni 7-19.pdf Kolegji Universitar i Biznesit - verifikimi i stafit akademik 22.11.2022.docx</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit</p> | <p>Personeli akademik efektiv e mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Departamenti i Menaxhimit përbëhet nga 7 pedagogë (si PAE) ku 3 pedagogë mbajnë gradën shkencore Dr, dhe 4 janë me master. Gjatë vitit</p> |

| | |
|--|---|
| <p>në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> | <p>2022 – 2023 për realizimin e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” janë angazhuar pedagogë me grada e tituj shkencorë, si dhe me raportin e duhur PAE/PAK. <i>Konstatohet që në vitin e parë të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi tek të dy profilet. Sugjerohet në të ardhmen që të ketë angazhim dhe të pedagogëve/profesionistëve të tjerë, ekspertë të fushës, kjo në interes reciprok të IAL dhe studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca</i> A4.48 & A4.49. <i>Stafi Akademik i Departamentit lendet e modulet.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> | <p>Bazuar në takimin tek IAL KUB, GVJ konstaton se ky institucion garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Kontratat e punësimit për stafin PAE për këtë program studimi, janë më kohëzgjatje të pacaktuar, dhe shumë prej tyre janë të punësuar prej vitesh në këtë IAL.</p> <p><i>Evidenca</i> Hulumtimi i dokumentave tek Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit (ZBNjAA)</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>IAL KUB i zhvillon procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel në përputhje legjislativonin në fuqi, me dokumentat: Rregulloren e marrëdhënies së punës, si dhe përcaktimet në Statutin e KUB. Njoftimet për vendet e lira shpallen në faqen e web-it të IAL KUB, njoftime të cilat përmbajnë kërkesat e përgjithshme dhe specifike, përkatëse sipas vendeve të lira të shpallura. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e saj, dhe miratohen nga Rektori. Vlerësimin e kandidatëve e bën një komision ad-hoc i ngritur posaçërisht për këtë procedurë. Procedura e përzgjedhjes kalon në këto faza: Paraqitja nga ana e kandidatit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës pranë ZBNjAA, ku kjo e fundit ia përcjell komisionit ad-hoc të ngritur; komisioni bën vlerësimin paraprak (me pikë) të kërkesave të paraqitura nga kandidatët, dhe bëhet intervistimi i kandidatëve dhe hartohet raporti nga ana e komisionit, dhe i dërgohet për miratim Rektorit. Vlerësimi final i çdo kandidati përbëhet nga pikët e dosjes dhe pikët nga intervista, ku në fund kandidatët renditen nga ai me pikët më të larta te ai më pikët më të ulëta. Pas përfundimit të procesit, nënshkruhet kontrata e punës nga Rektori dhe nxirret urdhëri i emërimit. Sipas drejtuesve të IAL KUB, kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi i kandidaturave</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>kanë të bëjnë me përshtatjen mes profilit të kërkuar dhe aftësive të kandidatëve, por merren në konsideratë edhe kriteret specifike, si përvoja e punësimit; aktiviteti kërkimor dhe botues; aftësitë e komunikimit, etj. Gjatë vizitës në IAL KUB, GVJ u njoh me disa dosje të procedurave të rekrutimit të personelit pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit, dhe konstatoi se këto procedura janë ndjekur për stafin e rekrutuar.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A4.50. Statuti KUB neni 41-53 Rregullorja e marrëdhënies së punës procedurat e rekrutimit dhe perzgjedhjes neni 7-19.pdf</i> <i>Dok 7. Politika e Burimeve Njerëzore.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me përfaqësuesen e zyrës së Burimeve Njerëzore, Administratës & Arkivit, dhe me drejtues të IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>Në takimin me drejtuesit dhe pedagogët e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, GVJ u informua që IAL KUB garanton realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve. Konkretisht, stafi i IT_{së} të IAL mirëmban dhe përditëson kompjuterat lidhur me paketat operuese të nevojshme për realizimin e orëve laboratorike, në lëndët në të cilat janë parashikuar laboratorë. Personeli ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ i institucionit kryejnë shërbime për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, këshillim dhe dhënie ndihmës për studentët, si dhe detyrat administrative në funksion të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Takimi me stafin e IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> | <p>Në bazë të vizitës në IAL KUB, si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit administrojnë dokumentacionin e punonjësve nga ana procedurale dhe dokumentare, shpalljen e vendeve të lira të punës, administrimin e formularëve të vlerësimit të performancës, etj. ZBNjAA është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të IAL KUB, të dhëna të cilat përfshijnë stafin PAE, PAK dhe atë administrativ, dhe të cilat mblidhen dhe administrohen në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë në fuqi. Gjatë vizitës në IAL KUB, në takimin me stafin e zyrës së Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit, GVJ konstatoi që kjo zyrë i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar, si dhe një pjesë të tyre në formë elektronike. GVJ u njoh me disa nga dosjet që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme, dosje të cilat përmbanin dokumentat e plota të personelit, të tilla si: dokumentin e identifikimit, kontratën e punës, CV, pozicionin e punës, diplomat, gradat dhe titujt</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>shkencorë, kualifikimet, etj. Një CV e përditësuar e stafit akademik gjendet dhe në sitemin personal të çdo pedagogu.</p> <p>GVJ konstaton se informacioni (të dhënat që kanë të bëjnë me programet e lëndës në të cilën stafi akademik është angazhuar në program, aplikimi për projekte, mobilitete etj) për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik mbahet nga Departamenti i Menaxhimit përgjegjës për programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Të dhëna ruhen dhe në sekretarinë e fakultetit, që kanë të bëjnë me procesin mësimor të ndjekur prej stafit akademik të angazhuar në programin e studimit si: procesverbale, dosjet e studentëve me dokumentacionin e regjistrimit, praktika mësimore, diploma etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> A4.51. <i>Formati i Dosjes personale te Stafit.pdf</i> A4.52. <i>Lista e Stafit Akademik ne kete program studimi 2016-2022.pdf</i> Dokumenti 3. - <i>Rregullore programit MSC MB.pdf</i> Takimi në IAL KUB me përfaqësuesin e zyrës së Burimeve Njerëzore, Administratës & Arkivit</p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>IAL KUB synon që të garantojë mbarëvajtjen e procesit mësimor duke e mbështetur këtë gjë përmes: marrëveshjeve me IAL të tjera publike dhe jo publike brenda dhe jashtë vendit, të tilla si me Universitetin Bujqësor të Tiranës, me Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës, me Universitetin Metropolitan Tirana; etj, bashkëpunim ky me këto institucione homologe për realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët, etj. Gjithashtu, ka marrëveshje me IAL të huaja në kuadër të shkëmbimeve/mobiliteteve Erasmus+ të stafit dhe studentëve në institucionet respektive. Gjithashtu, IAL KUB ka marrëveshje për sigurimin e praktikave (dhe për ndihmë në punimin e diplomës) mësimore në kompani & institucione të tilla si me: Confindustria Albania, Mercedes-Benz, Studion ligjore Juris Consulting, shoqërinë Ditak shpk, Kazazi Consulting shpk, E-Adviser shpk, Studio konsulence 94 shpk, TSTS Group; etj. Gjithashtu, personalitete të ndryshme nga jeta publike dhe nga kompani private në periudha të ndryshme kanë mbajtur leksione të hapura në IAL KUB.</p> <p>Përsa i përket udhëheqjes së punimit të diplomës kjo bëhet kryesisht nga PAE, të cilët gjithashtu kanë kualifikimin e duhur në përshtatje me programin e studimit.</p> <p><i>Nga GVJ sugjerohet që IAL KUB të ketë më shumë marrëveshje me IAL të vendit dhe të huaja (për realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik, ashtu dhe për studentët, projekte, etj), si dhe me institucione publike & private (për realizimin e praktikës profesionale, apo për ndihmë në punimin e diplomës, etj).</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> |

| | |
|--|--|
| | <p><i>A4.53. Disa personalitet nga biznesi ne udheheqje dhe ne leksione te hapura apo program mesimor ne MB, Marreveshje TIP.pdf</i></p> <p><i>A1.14. Marreveshje bashkepunimi me UBT, UAMD.pdf</i></p> <p><i>A1.16. Partneritet ne bashkepunim. Modeli i marrevershjes se bashkepunimit te KUB lista marreveshje konfindustria.pdf</i></p> <p><i>Dok 22. marreveshjet.pdf</i></p> <p><i>7. Marreveshje bashkepunimi Kazazi.pdf</i></p> <p><i>A4.57. Lista e Marreveshjes me Kompani.pdf</i></p> |
| <p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> | <p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, konstatohet nga GVJ që personeli mbikqyrës në institucionet publike dhe kompanitë private që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve që ka IAL KUB me to, i ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve/raportin përfundimtar të praktikës si dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Konkretisht, personi mbikqyrës (pjesë e këtyre institucioneve publike apo kompanive private) plotëson formularin përkatës të vlerësimit të studentit për praktikën e ndjekur nga studentët në institucionet/kompanitë e tyre, vlerësim i cili është pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentit lidhur me praktikën mësimore (që normalisht ka dhe kreditet ECTS).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët</i></p> <p><i>A4.53. Disa personalitet nga biznesi ne udheheqje dhe ne leksione te hapura apo program mesimor ne MB, Marreveshje TIP.pdf</i></p> <p><i>A1.14. Marreveshje bashkepunimi me UBT, UAMD.pdf</i></p> <p><i>A1.16. Partneritet ne bashkepunim. Modeli i marrevershjes se bashkepunimit te KUB lista marreveshje konfindustria.pdf</i></p> <p><i>Dok 22. marreveshjet.pdf</i></p> <p><i>7. Marreveshje bashkepunimi Kazazi.pdf</i></p> <p><i>A4.57. Lista e Marreveshjes me Kompani.pdf</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur kryesisht atë. Bazuar në konstatimin që në vitin e parë të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi tek të dy profilet, sugjerohet në të ardhmen që të ketë angazhim dhe të pedagogëve/profesionistëve të tjerë, ekspertë të fushës, kjo në interes reciprok të IAL dhe studentëve; si dhe nga GVJ sugjerohet që IAL KUB të ketë më shumë marrëveshje me IAL të vendit dhe të huaja (për realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik, ashtu dhe për studentët, projekte, etj), si dhe me institucione publike & private (për realizimin e praktikës profesionale, apo për ndihmë në punimin e diplomës, etj).</p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------------|-----------------------|
| | X | |

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>GVJ vizitoi mjediset e IAL KUB dhe konstatoi, bazuar edhe tek dokumentacioni mbështetës, se institucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në një ambient (me qera, në Tiranë), që ofron një infrastrukturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme (lidhur me hapësirën, akustikën, temperaturën, ndriçimin, lagështirën, etj) për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM nr.418, datë 10.05.2017.</p> <p>Në mjediset e IAL KUB gjenden sallat/auditorët e leksioneve, të seminareve, laboratorit i informatikës, një sallë konferencash dhe biblioteka.</p> <p><i>Evidenca:</i> A4.55. <i>Infrastruktura dhe mjediset KUB.pdf</i> A4.56. <i>Relacion Teknik per ambientet dhe infrastrukturen.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Bazuar në vizitën në mjediset e IAL KUB dhe dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se klasat janë të pajisura me kompjuter (për pedagogun) dhe videoprojektor, dhe me lidhje interneti wi-fi që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Për qëllime të organizimit të aktiviteteve shkencore të tilla si konferenca, seminare, leksione të hapura, etj, aktivitete sociale apo kulturore, mund të shfrytëzohet salla e konferencave. Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më mirë të procesit mësimor (instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i IT), ku instalimet e programeve të reja bëhen në bazë të kërkesave të pedagogëve apo azhurnimit periodik të tyre.</p> |

| | |
|---|---|
| | <p><i>Evidenca:</i> A4.55. <i>Infrastruktura dhe mjediset KUB.pdf</i> A4.56. <i>Relacion Teknik per ambientet dhe infrastrukturen.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>IAL KUB, për programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, disponon dy laboratorë informatike të pajisur me PC për çdo student, ku studentët përdorin programe specifike profesionale sipas lëndëve që zhvillojnë. Infrastruktura e rrjetit kompjuterik mirëmbahet nga stafi i IT, i cili mundëson monitorimin dhe sigurinë fizike të pajisjeve informatike. Për vitin akademik 2022-2023, 6 studentë po ndjekin programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik”, dhe 12 studentë atë me profil “Menaxhim Marketingu”, kështu që është lehtësisht e menaxhueshme pjesa e nevojës për përdorimin e laboratorëve.</p> <p>IAL KUB i kushton rëndësi teknologjisë, laboratorëve dhe programeve kompjuterike, të cilat shfrytëzohen për module apo lëndë të ndryshme (lëndët/modulet që kërkojnë realizimin e detyrave nga ana e studentit, mund të shfrytëzojnë laboratorët si dhe programet e instaluar në këto laboratorë për realizimin e këtyre detyrave).</p> <p>GVJ arrin në përfundimin se mjediset mësimore (klasat, laboratorët, salla e konferencave, biblioteka, etj) të IAL KUB janë në mbështetje të plotë të realizimit të objektivave të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”.</p> <p><i>Evidenca:</i> A4.55. <i>Infrastruktura dhe mjediset KUB.pdf</i> A4.56. <i>Relacion Teknik per ambientet dhe infrastrukturen.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> | <p>IAL KUB disponon dy laboratorë informatike të pajisur me kompjutera personalë për çdo student, ku studentët përdorin programe specifike profesionale sipas lëndëve që zhvillojnë, programe të instaluar të cilat përfshijnë: Financa 5, Alpha, etj. Laboratorët e teknologjisë së informacionit janë në dispozicion të studentëve për tu shfrytëzuar brenda orareve të mësimin, por edhe jashtë orarit të mësimin për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës. Infrastruktura e rrjetit kompjuterik mirëmbahet nga stafi i IT, i cili mundëson monitorimin dhe sigurinë fizike të pajisjeve informatike.</p> <p><i>Evidenca:</i> A4.55. <i>Infrastruktura dhe mjediset KUB.pdf</i> A4.56. <i>Relacion Teknik per ambientet dhe infrastrukturen.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet</p> | <p>Nga informacioni që GVJ mori në takimin me Përgjegjësën e Departamentit të Menaxhimit si dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, sipas tyre, IAL KUB ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me</p> |

| <p>marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p> | <p>kompani të sektorit publik dhe privat, të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi. Sipas planit mësimor të PS MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, praktika profesionale/mësimore është 75+75=150 orë dhe 12 ECTS, ku studenti i realizon pranë institucioneve/kompanive me të cilat IAL KUB ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe disa orë mund të përdoren gjithashtu edhe në ambientet e IAL KUB. Në dokumentin Udhëzuesi i Praktikave, jepet një informacion mbi gjithë procesin që ka lidhje me zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve (rekomandimet për institucionet/kompanitë sipas fushave, të drejtat dhe detyrimet e tyre, frekuentimin, dokumentat dhe formularët për tu plotësuar, formatin e raportit përfundimtar për tu përgatitur, mënyrën e vlerësimit, etj) pranë institucioneve/kompanive publike e private, etj. Por studentët, me kontaktet e tyre mund të zgjedhin vetë një kompani/institucion ku duan të ndjekin praktikën dhe t’ja propozojnë departamentit respektiv për konfirmim. GVJ konstaton se IAL KUB i ofron studentëve mundësitë për të realizuar praktika profesionale në përputhje me standardet.</p> <p><i>Evidenca:</i> A6.85. Udhëzuesi i Praktikave.pdf A2.20. Dosja e Departamentit, Udhëzimet per diplomën e praktiken.pdf A5.63. Raport praktike.pdf A5.73. Model Udhëzime dhe Raporti i praktikës model.pdf A4.48. Model marreveshje bashkepunimi dhe vleresimit te praktikës.pdf RVB e IAL KUB</p> | | | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p> | <p>IAL KUB në mënyrë të vazhdueshme pasuron literaturën në përputhje me kurrikulat mësimore për të garantuar marrjen e dijeve të duhura të parashikuara në programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Departamenti i Menaxhimit harton plane të detajuara për shtimin e librave në bibliotekë dhe i bën në mënyrë të vazhdueshme propozime Dekanit dhe Administratorit të IAL KUB për blerjen e librave të rinj</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>mësimorë. Në mënyrë të vazhdueshme bëhen blerje të librave, të artikujve shkencore, si dhe biblioteka pasurohet dhe me revista shkencore në fushën e ekonomisë. Sipas drejtuesve të IAL KUB, për literaturën digjitale, kanë marrëveshje me JSTOR dhe QUESTIA (paraqitur faturë pagese nga IAL KUB lidhur me JSTOR) ... por sugjerohet nga GVJ që të vihet në dispozicion dhe marrëveshja/kontrata e plotë me ta.</p> <p>Sipas drejtuesve të IAL KUB, literatura digjitale i mundëson stafit akademik të programit të studimit si dhe institucionit e studentëve një larmi përzgjedhje dhe shërbimesh të cilat lehtësojnë marrëdhënien pedagog-student si dhe ndihmojnë procesin e mësimdhënies e mësimnxënies. Shërbimi për stafin akademik dhe studentët jepet pa pagesë, duke përfituar prej platformës e cila i mundëson stafit dhe studentëve që të kenë dhe përdorin një literaturë të pasur të botimeve dhe punimeve shkencore që përditësohen në vazhdimësi.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A4.58. Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i></p> <p><i>1. Gjendja e librave per programin.pdf</i></p> <p><i>2. Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> | <p>Departamentet me Bibliotekën koordinohen për situatën e librave në bibliotekë për çdo fushë, si dhe për mundësinë e pajisjes me literaturë e botime të viteve të fundit.</p> <p><i>Sugjerohet që për fushën e programit të studimit në fjalë, të ketë më shumë literaturë me botime të viteve të fundit në gjuhën shqipe dhe të huaj.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A4.58. Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i></p> <p><i>1. Gjendja e librave per programin.pdf</i></p> <p><i>2. Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>GVJ vizitoi bibliotekën e IAL KUB të vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional, e cila si njësi ndihmëse ushtron aktivitetin e saj brenda hapësirës së IAL dhe ofron mundësi aksesit për të gjithë studentët dhe stafin. Studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj, paradite ose mbasdite nga dita e Hënë në të Premte, dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave të studentëve. Sipas drejtuesve të IAL KUB, studentët kanë të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të përdorimit të një bibliotekë me libra të printuar dhe biblioteka digjitale: JSTOR dhe QUESTIA, e cila iu vjen në ndihmë atyre për ecurinë normale të procesit mësimor dhe atë të punës shkencore.</p> |

| | |
|---|--|
| | <p><i>Sipas drejtuesve të IAL KUB, për literaturën digjitale, kanë marrëveshje me JSTOR dhe QUESTIA (paraqitur faturë pagese nga IAL KUB lidhur me JSTOR) ... por sugjerohet nga GVJ që të vihet në dispozicion dhe marrëveshja/kontrata e plotë me ta.</i></p> <p>Biblioteka ka një fond me libra në fusha të ndryshme të interesit të IAL KUB, duke përfshirë dhe literaturën përkatëse për programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, koleksion i cili pasurohet me tituj të ndryshëm me kalimin e kohës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A4.58. Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i></p> <p><i>1. Gjendja e librave per programin.pdf</i></p> <p><i>2. Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se biblioteka disponon në fondin e saj tituj në gjuhën shqipe dhe tituj në gjuhë të huaj, ku një pjesë e librave fizikë janë të dedikuara për fushën e ekonomisë, si dhe një numër të konsiderueshëm revistash, cikël leksionesh dhe materiale të tjera në ndihmë të studentëve. Përveç bibliotekës fizike, ekziston dhe biblioteka digjitale: JSTOR dhe QUESTIA, e cila iu vjen në ndihmë atyre për ecurinë normale të procesit mësimor dhe atë të punës shkencore, por <i>sugjerohet nga GVJ që të vihet në dispozicion dhe marrëveshja/kontrata e plotë me ta.</i></p> <p>Në takimin me Përgjegjësën e Departamentit të Menaxhimit dhe punonjësen e bibliotekës, konstatohet që në fund të vitit akademik, biblioteka bashkëpunon me departamentin dhe dërgon një formular për kërkesë librash për të gjithë personelin e departamentit, duke i lejuar stafit akademik që të japin informacione në lidhje me titujt që ata mendojnë se duhen patur e të jenë në gjendje në bibliotekë për vitin e ardhshëm akademik. Lista e materialeve akademike të kërkuar nga pedagogët i dërgohet administratorit të KUB me kërkesën për librat përkatës, dhe më pas fillohen blerjet sipas mundësive.</p> <p><i>Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se IAL KUB ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në gjuhën shqipe dhe të huaj (sidomos të viteve të fundit) për të mbështetur nevojat e programit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A4.58. Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <p>1. <i>Gjendja e librave per programin.pdf</i> 2. <i>Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i> A4.60. <i>Gjendja e sotme ne biblioteke. Inventari i saj.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> | <p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës së IAL KUB, si dhe mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar & takimi me studentët, GVJ u informua nga punonjësja e bibliotekës që institucioni ka zgjedhur të bëjë abonimin në bibliotekat digjitale JSTOR dhe QUESTIA, e cila iu vjen në ndihmë atyre për ecurinë normale të procesit mësimor dhe atë të punës shkencore në mënyrë që dhe shërbimi të jetë në përputhje me nevojat që kërkon stafi dhe studentët, si dhe u konstatua që kushtet për akses janë të barabarta e pa pagesë për studentët në aksesimin e bibliotekës on-line. <i>Sipas drejtuesve të IAL KUB, për literaturën digjitale, kanë marrëveshje me JSTOR dhe QUESTIA (paraqitur faturë pagese nga IAL KUB lidhur me JSTOR) ... por sugjerohet nga GVJ që të vihet në dispozicion dhe marrëveshja/kontrata e plotë me ta.</i></p> <p>Shërbimi bibliotekar kryhet nga staf efektiv që kryen dhe detyrën e lektore, shërbim i cili ofrohet për studentët & stafin akademik të fakultetit. Biblioteka ka një kapacitet prej 25-28 vendesh. Oraret që biblioteka qëndron e hapur për studentët dhe stafin është në ditët: E Hënë – E Premte, 9⁰⁰-15⁰⁰ & 16⁰⁰-20⁰⁰. Përveç aksesimit të bibliotekës online në ambientet e bibliotekës së IAL KUB, studentët dhe stafi mund të shfletojnë materialet e bibliotekës në një sallë leximi të përshtatshme, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme.</p> <p><i>Evidenca:</i> A4.58. <i>Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i> 1. <i>Gjendja e librave per programin.pdf</i> 2. <i>Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i> A4.60. <i>Gjendja e sotme ne biblioteke. Inventari i saj.pdf</i> RVB e IAL KUB (f.49)</p> |
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p> | <p>Biblioteka e IAL KUB ka një kapacitet prej 25-28 vendesh dhe qëndron e hapur për studentët & stafin në ditët: E Hënë – E Premte, 9⁰⁰-15⁰⁰ & 16⁰⁰-20⁰⁰). Punonjësja në bibliotekë vihet në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik për të lehtësuar procesin e gjetjes së librave apo revistave të caktuara dhe për t'ju ardhur në ndihmë për pyetje potenciale. Përdorimi i internetit është pa kufizim nga ana e të gjithë pedagogëve dhe studentëve.</p> |
| | <p><i>Megjithatë GVJ sugjeron që të instalohen dhe disa kompjutera personalë/laptopë në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> |

| | |
|--|---|
| | <p><i>A4.58. Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i></p> <p><i>1. Gjendja e librave per programin.pdf</i></p> <p><i>2. Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i></p> <p><i>Aneksi A4.60. Gjendja e sotme ne bibloteke. Inventari i saj.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> | <p>Në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në bibliotekën e IAL KUB dhe nga takimi me studentët, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve në ditët: E Hënë – E Premte, 9⁰⁰-15⁰⁰ & 16⁰⁰-20⁰⁰. GVJ gjykon që orari është i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e interesuar duke qenë në një hapësirë të gjerë orari (paradite, drekë dhe pasdite), pa cënuar orarin e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A4.58. Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i></p> <p><i>1. Gjendja e librave per programin.pdf</i></p> <p><i>2. Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i></p> <p><i>A4.60. Gjendja e sotme ne bibloteke. Inventari i saj.pdf</i></p> <p><i>Takimi me punonjësen e bibliotekës të IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p> | <p>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse për programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe atë online, përditësimin e tij çdo vit, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij online nga stafi akademik dhe studentët e PS, shfrytëzimin e sallave të studimit, dhe kërkesat për tituj (çdo fund viti kemi bashkëpunim Bibliotekë-Departament për parashikimin e blerjeve të titujve për vitin pasardhës).</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A4.58. Lista e inventarit te Librave te Biblotekes.pdf</i></p> <p><i>1. Gjendja e librave per programin.pdf</i></p> <p><i>2. Kontraten, abonimin me JSTORY-n.pdf</i></p> <p><i>A4.60. Gjendja e sotme ne bibloteke. Inventari i saj.pdf</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur kryesisht atë.</i></p> <p><i>- Sipas drejtuesve të IAL KUB, për literaturën digjitale, kanë marrëveshje me JSTOR dhe QUESTIA (paraqitur faturë pagese nga IAL KUB lidhur me JSTOR) ... por sugjerohet nga GVJ që të vihet në dispozicion dhe marrëveshja/kontrata e plotë me ta.</i></p> <p><i>- Pavarësisht se IAL KUB ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në gjuhën shqipe dhe të huaj (sidomos të viteve të fundit) për të mbështetur nevojat e programit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”.</i></p> |

| | | | |
|-------------------------------------|---|---------------------|----------------------|
| | - GVJ sugjeron që të instalohen dhe disa kompjutera personalë/laptopë në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbyhet | Përmbyhet kryesisht | Përmbyhet plotësisht |
| | | | X |

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> | <p>IAL KUB ka një sistem menaxhimi të njohur ndryshe si PORTAL KUB përmes të cilit organizohen dhe administrohen të gjitha proceset mësimore të fakulteteve dhe të programeve që ata ofrojnë, sistem i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritet) dhe ai akademik i institucionit (nëpërmjet një username dhe fjalëkalimi të mundësuar nga stafi i IT i IAL KUB). Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore të IAL KUB, GVJ u informua se informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim administrohet nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore administrohet gjithë informacionin që lidhet me studentët, të dhënat personale të tyre, si kontratat e studentëve, numrat e matrikullimit, regjistrat e amzës, procesverbalet e provimeve, notat, etj. GVJ u njoh me regjistrat gjatë vizitës në IAL KUB dhe dosjet personale të studentëve, dhe zgjodhi në mënyrë të rastësishme disa emra studentësh të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” (për vitin akademik 2022-2023, 6 studentë po ndjekin programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik”, dhe 12 studentë atë me profil “Menaxhim Marketingu”) dhe konstatoi që të dhënat e tyre në dosje, notat në regjistër dhe procesverbale, numrat e matrikullimit, etj, ishin pasqyruar korrekt nga ana e sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Evidenca:</i> A4.61. Organigrama e KUB.pdf 14. Rregullore sekretarie.pdf Vizita e GVJ në zyrën e sekretarisë mësimore</p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit, është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të IAL KUB, zyrë e cila i mban të dhënat e personelit akademik, atij ndihmës akademik, dhe personelit</p> |

| | |
|---|--|
| <p>akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit në dosje personale në format të printuar. Dosjet e personelit përditësohen periodikisht dhe në to gjenden këto dokumenta të tilla si CV_{te} e personelit; pozicioni i punës; diplomat dhe gradat/titujt shkencorë; fotokopje të dokumentit të identifikimit dhe adresës së vendbanimit; formular vetëdeklarimi apo dëshmi penaliteti; kualifikime të tjera / informacione shtesë, etj. Sistemi PORTAL KUB në varësi të aksesit përdoret prej stafit administrativ (si sekretaritë e fakulteteve), studentëve dhe stafit akademik & ndihmës akademik. Stafi i IT_{se} vendos në shërbim të stafit akademik & ndihmës akademik, dhe atij administrativ të institucionit një adresë të personalizuar me emrin dhe mbiemrin e tyre, në mënyrë që të identifikohen në sistemin online. Ndërveprimi mes stafit akademik dhe studentëve zhvillohet përmes komunikimit me e-mail dhe studentët mund të përdorin gjithashtu sistemin PORTAL KUB (për të shkarkuar materialët mësimore, slide, të ngarkuara nga pedagogët e lëndës), etj. Rezultatet e provimeve plotësohen manualisht në procesverbale nga pedagogët përkatës, nga ku më pas nëpërmjet sistemit PORTAL KUB i mundësohet sekretarive mësimore të hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve, programeve përkatëse ku bëjnë pjesë. Studentët më pas mund t'i shohin rezultatet e tyre nga sistemi PORTAL KUB.</p> <p><i>GVJ sugjeron që sistemi i hedhjes së notave të azhurnohet, nga ku vetë pedagogët t'i hedhin notat në sistem, kjo për të shkurtuar kohën dhe për të siguruar efektivitet të gjithë procesit.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Dok 7. Politika e Burimeve Njerezore.pdf</i> <i>A4.51. Formati i Dosjes personale te Stafit.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me përfaqësuesen e zyrës së Burimeve Njerezore, Administratës dhe Arkivit dhe me përfaqësues të sekretarisë mësimore RVB e IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë faqen web të IAL KUB (www.kub.edu.al), si dhe të aksesojnë sistemin PORTAL KUB, ku aksesit tek informacioni dhe dokumentacioni personelin dhe studentët bëhet duke ruajtur privatësinë. Informacioni është i dedikuar dhe personal, ku aksesit ka kufizime sipas kategorisë të secilit përdorues: staf administrativ, student apo pedagog, me username-n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. stafi akademik iu jep akses online studentëve në dokumenta të tilla si: të kontrollojnë informacione rreth tyre, mbi syllabuset e lëndëve, materialet mësimore, informacion mbi frekuentimin, notat, kreditet, rezultatet për lëndët që ndjekin, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi pedagog-student. Çdo student mund të shikojë të dhënat personale të tij, por nuk ka akses në ndryshimin e rezultateve akademike.</p> |

| | |
|---|---|
| | <p><i>Evidenca:</i> <i>Takimi në IAL KUB me drejtues të IAL KUB</i> <i>RVB e IAL KUB</i> <i>Faqja web e IAL KUB: www.kub.edu.al</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>Personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë faqen web të IAL KUB (www.kub.edu.al), si dhe të aksesojnë sistemin PORTAL KUB (të gjithë ata përdorues që janë të pajisur me një adresë zyrtare nga IAL KUB) me username_n dhe fjalëkalimin përkatës, ku nëpërmjet këtij sistemi, psh. stafi akademik iu jep akses studentëve në dokumenta të tilla si: syllabuset e lëndëve, materialet mësimore të uploaduara (slide, etj), informacion mbi frekuentimin, notat, kreditet, etj, dhe shërben si mënyrë komunikimi interaktive pedagog-student dhe për të shkëmbyer informacion ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Stafi akademik mund të ngarkojë leksionet dhe materialet mësimore në sistem, nga ku studentët mund t'i shkarkojnë lehtësisht. Stafi akademik dhe studentët përdorin gjithashtu dhe platformat si Google Classroom & Google Meet si forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre (sidomos këto platforma janë përdorur shumë gjatë kohës së pandemisë Covid-19).</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Faqja web e IAL KUB: www.kub.edu.al</i> <i>A3.43. Rregullorja e zhvillimit të procesit mesimor online.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> | <p>Duke përdorur faqen web të IAL KUB dhe sistemin PORTAL KUB, mund të shkëmbehet informacion midis stafit akademik dhe studentëve (si dhe aksesim nga studentët për të gjithë materialin që lidhet me procesin mësimor). Sistemi i menaxhimit PORTAL KUB garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, rezultatet e provimeve, etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese. Komunikimi ndërmjet palëve në IAL KUB realizohet edhe nëpërmjet postës elektronike (me adresat e email_{it} të domain_{it} www.kub.edu.al). Formë tjetër komunikimi janë edhe platformat e ndryshme të rrjeteve sociale, nëpërmjet të cilave bëhet komunikimi jo vetëm midis personelit dhe studentëve, por edhe shpërndahet informacion për palët e treta të interesuara për programet e studimit në IAL KUB.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Faqja web e IAL KUB: www.kub.edu.al</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në</p> | <p>GVJ konstaton që informacionet që lidhen me programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, me personelin akademik, informacioni mbi</p> |

| <p>të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> | <p>kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimin e bursave të studimit, informacionin mbi aktivitetet e ndryshme që lidhen me IAL KUB, gjenden në faqen e web-it https://www.kub.edu.al (të cilat publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze). Ndërkohë, në faqen web www.kub.edu.al ndodhet një seksion i veçantë për studentët, ku gjenden informacione për qeverinë studentore, konferencat studentore, aktivitetet sociale dhe sportive, procesin e diplomimit, procesin e punësimit, kalendarin akademik, etj. IAL KUB i publikon informacionet e veta dhe në kanale të tjera të informimit dhe median sociale (si Instagram, LinkedIn, etj).</p> <p><i>Evidenca:</i> Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it Faqja web: www.kub.edu.al</p> | | | | | | | | |
|---|--|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë. GVJ sugjeron që sistemi i hedhjes së notave të azhurnohet, nga ku vetë pedagogët t'i hedhin notat në sistem, kjo për të shkurtuar kohën dhe për të siguruar efektivitet të gjithë procesit.</i></p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 958 770 1032">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="770 958 1002 1032">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1002 958 1209 1032">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1209 958 1410 1032">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="595 1032 770 1079"></td> <td data-bbox="770 1032 1002 1079"></td> <td data-bbox="1002 1032 1209 1079"></td> <td data-bbox="1209 1032 1410 1079" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> | <p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se IAL KUB jep të dhëna financiare të kostove në nivel institucional, ku pasqyrohen të ardhurat (nga tarifat e shkollimit të studentëve studentëve, nga trajnimet & projektet, të ardhura administrative, dhe nga burime të tjera) dhe shpenzimet (operative, administrative, për investime, për kërkim shkencor, etj). Gjithashtu përgatitet buxheti nga administratori në përputhje me parashikimet ligjore, Statutin dhe Rregulloret e IAL KUB. Departamentet e IAL KUB paraqesin kërkesat e tyre për vitin e ri akademik, të cilat pas miratimit në nivelet përkatëse përcillen në zyrën e financës i cili bën unifikimin e tyre brenda buxhetit të IAL si një njësi e vetme.</p> <p><i>GVJ sugjeron që duhej një raport më i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> |

| | |
|---|--|
| | <p><i>A4.62. Relacioni per treguesit e vitit 2021 dhe parashikimi 2022 fq 6-7.pdf</i></p> <p><i>A4.64. Raporti vjetor 2021-2022 fq 62-64 Relacion per realizimin e treguesve financiar 3-5.pdf</i></p> <p><i>A4.66 Raporti vjetor fq 62-64 Relacione per realizimin e treguesve financiar 12-13.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> | <p>Plani i financimit përmban zëra të tillë si financimi i burimeve njerëzore, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzimet për paga, shpenzimet për kërkim shkencor, shpenzimet për investime, si dhe shpenzime të tjera. Nga drejtuesit e IAL KUB është vënë si objektivi rritja e të ardhurave nga projektet e ndryshme.</p> <p><i>Nga GVJ sugjerohet që duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vete!).</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A4.62. Relacioni per treguesit e vitit 2021 dhe parashikimi 2022 fq 6-7.pdf</i></p> <p><i>A4.64. Raporti vjetor 2021-2022 fq 62-64 Relacion per realizimin e treguesve financiar 3-5.pdf</i></p> <p><i>A4.66 Raporti vjetor fq 62-64 Relacione per realizimin e treguesve financiar 12-13.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> | <p>IAL KUB kryen auditim financiar të brendshëm dhe të jashtëm të pavarur në mënyrë periodike. Raportet e auditit japin opinione në lidhje me aspektet materiale, pozicionin dhe performancën financiare, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi. Pjesa financiare është e rëndësishme për të gjithë grupet e interesit: pedagogë, studentë, staf ndihmës akademik dhe staf administrativ.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A6.84. Raporti i Grant Thornton.pdf</i></p> <p><i>RVB e IAL KUB</i></p> <p><i>Takimi me drejtues të IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> | <p>IAL KUB raporton në nivel institucional mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> <p><i>GVJ sugjeron që duhej raportim deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</i></p> |

| | | |
|--------------------|---|--|
| | | <p><i>Evidenca:</i></p> <p>A4.62. <i>Relacioni per treguesit e vitit 2021 dhe parashikimi 2022 fq 6-7.pdf</i></p> <p>A4.64. <i>Raporti vjetor 2021-2022 fq 62-64 Relacion per realizimin e treguesve financiar 3-5.pdf</i></p> <p>A4.66 <i>Raporti vjetor fq 62-64 Relacione per realizimin e treguesve financiar 12-13.pdf</i></p> <p>A4.63 <i>Relacioni per treguesit e V2021 fq 10-11.pdf</i></p> |
| Kriteri 5. | Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | <p>Pjesa financiare është e rëndësishme për të gjithë grupet e interesit: pedagogë, studentë, staf ndihmës akademik dhe staf administrativ. Bazuar në raportet vjetore për treguesit financiarë dhe nga takimi i GVJ me drejtuesit e IAL KUB të cilët shprehen entuziastë për ecurinë e institucionit, kjo tregon qëndrueshmëri dhe mjaftueshmëri financiare të IAL KUB për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p>A6.84. <i>Raporti i Grant Thornton.pdf</i></p> <p>A4.62. <i>Relacioni per treguesit e vitit 2021 dhe parashikimi 2022 fq 6-7.pdf</i></p> <p>A4.64. <i>Raporti vjetor 2021-2022 fq 62-64 Relacion per realizimin e treguesve financiar 3-5.pdf</i></p> <p>A4.66 <i>Raporti vjetor fq 62-64 Relacione per realizimin e treguesve financiar 12-13.pdf</i></p> <p>A4.63 <i>Relacioni per treguesit e V2021 fq 10-11.pdf</i></p> <p><i>RVB e IAL KUB</i></p> |
| Konkluzione | | <p>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur kryesisht atë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - GVJ sugjeron që duhej një raport më i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi. - Nga GVJ sugjerohet që duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vete!). GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore. |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| | - GVJ sugjeron që duhej raportim deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | X | |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | X | |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | <p>GVJ konstaton se IAL KUB ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me Statutin e IAL KUB, Rregulloren e përgjithshme dhe specifike të njësisë kryesore dhe asaj bazë që ofron programin e studimit, Rregulloren e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, si dhe në përputhje me me ligjin nr.80/2015, udhëzimin e MASR, nr.10, datë 15.05.2019, si edhe Udhëzimin e MASR, nr.17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve master. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”.</p> <p><i>Evidenca:</i> Dok 4. Misioni dhe strategjia.pdf Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf A1.9 Strategjia e zhvillimit te KUB 2021-2026 fq7-8, Statuti KUB neni 4, Rregullore e KUB, Neni 62,63 fq 42-43.pdf</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p><i>A1.7. Strategjia 2021- 2026, Statuti i KUB, Neni 4.pdf</i></p> <p>GVJ konstaton se politikat dhe procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Kjo gjë është e përcaktuar në Statutin dhe Rregulloret e IAL KUB që përcaktojnë të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë studentët e regjistruar në çdo program studimi të ofruar nga IAL KUB.</p> <p>Si mision, IAL KUB ka formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; krijimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarive inovative e profesionale për fushën e ekonomiksit, drejtësisë, shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare, teknologjisë së informacionit, fushave profesionale teknike & administrative; ofrimin e mundësive të barabarta për të përfutuar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës; integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor; nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë; dhe krijimin & mbështetjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në përputhje me Standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë duke reflektuar objektivat e procesit të Bolonjës.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>Dok 4. Misioni dhe strategjia.pdf</i></p> <p><i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i></p> <p><i>Aneksi A1.9 Strategjia e zhvillimit te KUB 2021-2026 fq7-8, Statuti KUB neni 4, Rregullore e KUB, Neni 62,63 fq 42-43.pdf</i></p> <p><i>Aneksi A1.7. Strategjia 2021- 2026, Statuti i KUB, Neni 4.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> | <p>IAL KUB verifikon kriteret e pranimit çdo vit akademik dhe bën renditjen e studentëve sipas këtyre kriterëve. IAL KUB publikon në website dhe në rrjetet sociale informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit për secilin nga ciklet e studimit. Kriteret rishikohen nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi në bashkëpunim me fakultetin përkatës. Kriteret për pranimin e studentëve në ciklet e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” tek IAL KUB propozohen nga njësia kryesore dhe më pas miratohen me vendim të Senatit Akademik të KUB, vendime të cilat i dërgohen më pas MAS, si dhe shpallen në ambientet e IAL KUB me qëllim informimin sa më të saktë dhe transparent të kandidatëve për studentë.</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>Me vendim të Senatit Akademik përcaktohen kriteret e përgjithshme (si përfundimi i studimeve të ciklit Bachelor dhe i maturës shtetërore, ose mesatarja ata që duan të aplikojnë për një program të dytë studimi), si dhe kriteret specifike/shtesë të cilat miratohen dhe shpallen çdo vit nga IAL KUB. Kriteret e pranimit për programin MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” janë të përcaktuara në rregulloren e fakultetit dhe atë të këtij programi studimi. Lidhur me transferimin e studimeve, pranimet nuk kanë kriteret specifike. Ekuivalentimi bëhet në përputhje me kërkesat e rregullore të ekuivalentimit të studimeve. Studentët aplikantë janë punonjës të institucioneve publike qendrore dhe vendore, kompanive private, organizatave jo fitimprurëse, etj të cilët plotësojnë të gjitha detyrimet ligjore sipas MAS dhe ato kontraktuale mes kandidatëve për studentë dhe IAL KUB. Më pas, përzgjedhja e studentëve bëhet mbi bazën e vlerësimit të dokumentacionit shoqërues.</p> <p><i>Evidenca:</i> Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf A5.66. Rregullore e ekuivalentimit te studimeve.pdf A2.21. Rregullore KUB neni 63, 66, Rregullore ekuivalentimi 73,74, Rreg e programit neni 5,6,12.pdf A1.9 Strategjia e zhvillimit te KUB 2021-2026 fq7-8, Statuti KUB neni 4, Rregullore e KUB, Neni 62,63 fq 42-43.pdf A1.7. Strategjia 2021- 2026, Statuti i KUB, Neni 4.pdf Dok 4. Misioni dhe strategjia.pdf Linku: https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet</p> |
| <p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>Bazuar në vizitën në IAL KUB dhe takimin me studentët, GVJ konstaton që kriteret dhe procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar nëpërmjet kanaleve të ndryshme formale të komunikimit. IAL KUB i shpall kriteret dhe procedurat e aplikimit, regjistrimit, pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, apo ato të transferimit të studimeve, pas miratimit të tyre në Senatit Akademik dhe aprovimit prej MAS, dhe i publikon në faqen web: www.kub.edu.al (si dhe në rrjete sociale si Facebook, LinkedIn, Instagram, etj), në mënyrë që tu bëjnë me dije të interesuarve të gjitha kriteret dhe procedurat që IAL KUB përdor zyrtarisht për aplikimin, regjistrimin, apo transferimin nga një IAL në tjetrin.</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Në ndihmë të studentëve të IAL KUB është edhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës & Sekretaria Mësimore & Koordinatori i Masterit që ndihmojnë me informacione të ndryshme, si ato mbi të drejtat dhe detyrimet, udhëzime për provimet, detyrat e kursit, frekuentimin, vlerësimin, politikat e pranimi, transferimit, bibliotekën, etj. Gjithashtu, edhe Guida Studentore vjen në ndihmë të studentëve për të siguruar informacione të ndryshme në interes të tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i> <i>A5.66. Rregullore e ekuivalentimit te studimeve.pdf</i> <i>A2.21. Rregullore KUB neni 63, 66, Rregullore ekuivalentimi 73,74, Rreg e programit neni 5,6,12.pdf</i> <i>A1.9 Strategjia e zhvillimit te KUB 2021-2026 fq7-8, Statuti KUB neni 4, Rregullore e KUB, Neni 62,63 fq 42-43.pdf</i> <i>A1.7. Strategjia 2021- 2026, Statuti i KUB, Neni 4.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/</i> <i>A3.47. Udhezimi per pergatijen e mikrotezes.pdf</i> <i>A3.41. Udhezim Mikroteze. Model vleresimi te mikrotezes Udheheqes Anetar Komisione.pdf</i> <i>A2.20. Dosja e Departamentit, Udhezimet per diplomen e praktiken.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhimit në IAL KUB, përpara fillimit të çdo viti akademik, realizon takime informuese me të interesuarit ku ofrohen informacione nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike (të veçanta) të pranimi në programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. IAL KUB merr pjesë në panairët e organizuara prej MAS ose në turet nëpër gjimnaze të ndryshme në vend, me synim informimin e maturantëve për mundësitë e studimit në IAL KUB, apo organizon dhe ditët e informimit me maturantët ku stafi akademik takohet me kandidatët virtualisht ose në IAL (ku iu shpjegohen kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit në programet që të interesuarit shfaqin interes, mundësitë e mobiliteteve, etj). Çdo kandidat i interesuar, për më shumë informacion mund të aksesojë faqen web të IAL: www.kub.edu.al.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> |

| | |
|--|--|
| | <p><i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i></p> <p><i>A5.66. Rregullore e ekuivalentimit te studimeve.pdf</i></p> <p><i>A2.21. Rregullore KUB neni 63, 66, Rregullore ekuivalentimi 73,74, Rreg e programit neni 5,6,12.pdf</i></p> <p><i>A1.9 Strategjia e zhvillimit te KUB 2021-2026 fq7-8, Statuti KUB neni 4, Rregullore e KUB. Neni 62,63 fq 42-43.pdf</i></p> <p><i>A1.7. Strategjia 2021- 2026, Statuti i KUB, Neni 4.pdf</i></p> <p><i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/</i></p> <p><i>A3.47. Udhezimi per pergatijen e mikrotezes.pdf</i></p> <p><i>A3.41. Udhezim Mikroteze. Model vleresimi te mikrotezes Udheheqes Anetar Komisione.pdf</i></p> <p><i>A2.20. Dosja e Departamentit, Udhezimet per diplomen e praktiken.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> | <p>IAL KUB harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e pranimit për secilin nga ciklet e studimit (të cilat i publikon në website & në rrjetet sociale).</p> <p><i>Por, GVJ sugjeron që IAL KUB të hartojë dhe publikojë përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>Takimi me drejtues të IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> | <p>IAL KUB harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e pranimit për secilin nga ciklet e studimit (të cilat i publikon në website & në rrjetet sociale).</p> <p><i>Por, GVJ sugjeron që IAL KUB të hartojë dhe publikojë përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>Takimi me drejtues të IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> | <p>IAL KUB jep ndihmë dhe bursa për studentët me mesatare të lartë (e ndarë në nivele të mesatares).</p> <p><i>Por, GVJ sugjeron që IAL KUB të hartojë politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</i></p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>Takimi me drejtues të IAL KUB</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</i></p> <p><i>Por, GVJ sugjeron që IAL KUB:</i></p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>- të hartojë dhe publikojë përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>- të hartojë dhe publikojë përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> <p>- të hartojë politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL KUB, si dhe në takimin me studentët, GVJ konstaton që IAL KUB informon në mënyrë të plotë studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre në lidhje me procedurat e përparimit akademik. Vlen për tu theksuar që kohëzgjatja e këtij programi studimi është 2 vite (4 semestra). Nëpërmjet sekretarisë mësimore studentët marrim informacion të rëndësishëm në lidhje me procesin mësimor, orarin, detyrimet akademike, provimet, etj. Në fillim të çdo semestri dhe për çdo lëndë/modul, personeli akademik iu prezanton studentëve syllabueset e lëndëve, procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, etj. Gjithashtu, informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve janë të përshkruara dhe në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit, dhe Rregulloren e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Në këto rregullore jepen dhe procedurat e pranimit të studentëve, ku shpjegohen kriteret e pranimit; procedurat për ankimimin; njëkohësisht informacion mbi frekuentimin e lëndëve, mungesat, vlerësimin; informacion mbi provimet, të drejtat dhe përgjegjësitë që ka studenti në lidhje me institucionin, stafin akademik, studentët, administratën etj; si dhe informacion që duhet të dijë studenti për progresin akademik & informacion mbi diplomimin, etj.</p> <p>Në shërbim të studentëve për të marrë një informacion sa më të detajuar është dhe faqja web e IAL: www.kub.edu.al, kategoria Studentët, ku jepet informacion për qeverinë studentore, konferencat studentore, aktivitetet sociale, aktivitetet sportive, kalendarin akademik, procesin e</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>diplomimit, etj. Në shërbim të studentëve për të marrë një informacion është dhe Guida Studentore.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i> <i>A5.66. Rregullore e ekuivalentimit te studimeve.pdf</i> <i>A2.21. Rregullore KUB neni 63, 66, Rregullore ekuivalentimi 73,74, Rreg e programit neni 5,6,12.pdf</i> <i>A3.47. Udhezimi per pergatijen e mikrotezes.pdf</i> <i>A3.41. Udhezim Mikroteze. Model vleresimi te mikrotezes Udheheqes Anetar Komisione.pdf</i> <i>A2.20. Dosja e Departamentit, Udhezimet per diplomen e praktiken.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> | <p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, si dhe nga takimi me studentët, GVJ konstaton se studentëve iu vihet në dispozicion informacion i plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Studentët mund të marrin informacion për transferimin nëpërmjet faqes zyrtare të web-it të IAL KUB, njoftimeve të publikuara në stendën e njoftimeve të IAL KUB dhe në rrjetet sociale. Kriteret e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme përcaktohen nga njësi bazë ofruese e programit të studimit.</p> <p>Departamenti i Menaxhimit në bashkëpunim me struktura të tjera organizative të IAL KUB janë të angazhuara në procesin e informimit të kandidatëve për student për të gjitha informacionet që ata janë të interesuar të dijnë rreth IAL KUB si dhe programeve të studimit ku ata duan të regjistrohen. Në rastin kur kandidati kërkon të njohë kualifikime të mëparshme, ai informohet mbi kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Pas paraqitjes së kërkesës nga student, ngrihet komision ad-hoc nga Departamenti i Menaxhimit për shqyrtimin e saj. Institucioni dhe Fakulteti i Ekonomisë pranojnë transferime sipas përcaktimeve në Rregulloren e Programit të studimit si dhe në bazë të kuotave të dorëzuara pranë MAS në fillim të vitit akademik. Studentët që kanë përfunduar studimet në një program tjetër studimi, kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e krediteve të lëndëve të njëjta ose të ngjashme, dhe kanë të drejtë të transferojnë vetëm lëndë të vlerësuara me notë përfundimtare kaluese.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i></p> |

| | |
|--|--|
| | <p><i>Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i></p> <p><i>A5.66. Rregullore e ekuivalentimit te studimeve.pdf</i></p> <p><i>A2.21. Rregullore KUB neni 63, 66, Rregullore ekuivalentimi 73,74, Rreg e programit neni 5,6,12.pdf</i></p> <p><i>Dok 18. Pranimi i studenteve.pdf</i></p> <p><i>A2.20. Dosja e Departamentit, Udhezimet per diplomen e praktiken.pdf</i></p> <p><i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/</i></p> <p><i>Linku: https://kub.edu.al/pranimet/</i></p> <p><i>Linku: https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Nga vizita në IAL KUB dhe takimi me studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Programit të studimit, Rregulloren e provimeve dhe Rregulloren e sekretarisë, dokumenta të cilat janë të aksesueshme për studentët e IAL KUB.</p> <p>Gjithashtu, studentët informohen në fillim të çdo semestri në çdo lëndë/modul për procedurat e vlerësimit të dijeve nga pedagogët e tyre, gjatë prezantimit të lëndës dhe syllabusit përkatës. Në secilin program lëndë, pedagogët kanë përfshirë vlerësimin e studentit, peshën që zë vlerësimin sipas komponentëve si dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit. Në javën e parë të semestrit që është edhe java e orientimit, studentët informohen prej stafit akademik dhe prej secilit pedagog për lëndën përkatëse, mbi elementët e programit të lëndës, duke përfshirë dhe vlerësimin. Edhe Sekretaria Mësimore informon studentët për çështje që kanë lidhje me sekretarinë apo çdo gjë tjetër.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>Dokumenti 3. Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>Dok 13. Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf</i></p> <p><i>14. Rregullore sekretarie.pdf</i></p> <p><i>A2.25 Syllabuset Menaxhim Marketingu.pdf</i></p> <p><i>A2.25 Syllabuset Administrim Publik.pdf</i></p> <p><i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i></p> <p><i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i></p> <p><i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në IAL KUB përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit. Studentët njihen gjithashtu edhe me formularin që duhet të plotësojnë për të aplikuar për zgjedhjen e temës së diplomës si dhe</p> |

| | | |
|---|--|--|
| | | <p>caktimin e pedagogut udhëheqës (atyre u shpërndahen tematikat e sugjeruara për tu zgjedhur prej tyre për diplomim, si dhe u shpjegohen procedurat e punimit të temës së diplomës dhe rregullorja përkatëse). IAL KUB informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në takimet që njësitë bazë bashkë me koordinatorët zhvillojnë gjatë vitit. Informimi bëhet para se të fillojë semestri i dytë i vitit të dytë (kohëzgjatja e këtij programi studimi është 2 vite) dhe zgjedhja e temës së punimit bëhet para se të fillojë periudha e praktikës profesionale. Gjithashtu në javën e orientimit (në fillim të çdo semestri) studentëve u jepen prej drejtuesve të IAL informacione të detajuara lidhur me diplomimin. Në takimin rre studentët gjatë vizitës në IAL KUB, GVJ konstatoi se studentët kishin marrë informacionin e nevojshëm për procesin e diplomimit të tyre.</p> <p><i>Evidenca:</i> A3.47. <i>Udhëzimi për përgatitjen e mikrotezes.pdf</i> A3.41. <i>Udhëzim Mikroteze. Model vlerësimi të mikrotezes Udheheqes Anetar Komisione.pdf</i> A2.20. <i>Dosja e Departamentit, Udhëzimet për diplomën e praktiken.pdf</i> Dokumenti 3. <i>Rregullore programit MSC MB.pdf</i> Dok 13. <i>Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf</i> 14. <i>Rregullore sekretarie.pdf</i> A2.25 <i>Syllabuset Menaxhim Marketingu.pdf</i> A2.25 <i>Syllabuset Administrim Publik.pdf</i> Dok 1. <i>Rregullore të përgjithshme dhe specifike.pdf</i> A5.67. <i>Guida Studentore.pdf</i> A1.13. <i>Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> | | <p>GVJ konstaton se IAL KUB në fillim të çdo viti akademik, në mënyrë periodike përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi të hapura me ta, nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e cila bashkëpunon me Departamentin e Menaxhimit (krahas departamenteve të tjera) për programin e studimit MSH në “Menaxhirn Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” (dhe programe të tjera). Informimi i publikut bëhet me takime të drejtpërdrejta, në faqen zyrtare web, njoftimet në stendat e IAL KUB, nëpërmjet fletë palosjeve, broshurave, rrjeteve sociale, etj. Studentët që potencialisht mund të jenë pjesë e KUB në të ardhmen informohen mbi programin e studimit që do të ndjekin dhe elementët kryesorë që lidhen me procesin mësimor. IAL KUB ka marrë pjesë në të gjitha panairt e zhvilluara, si panairi Work & Study, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>Dokumenti 3. Rregullore e programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 13. Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>14. Rregullore sekretarie.pdf</i></p> | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</i></p> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> | <p>IAL KUB siguron mundësitë që programet e studimeve që ofrohen të njihen nga studentët dhe të interesuarit duke i publikuar ato përmes fletëpalosjeve, prezantuar në publik, etj. Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua që informacionet në lidhje me strukturën e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, organizimin dhe kohëzgjatjen iu vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve të tyre. Gjatë vizitës në IAL KUB, GVJ u informua se çdo vit akademik Departamenti i Menaxhimit, krahas departamenteve të tjera, së bashku me njësinë kryesore organizojnë takime informuese të përshtatjes së studentëve me IAL KUB dhe programin e studimit. Studentët marrin informacion në fillim të çdo semestri nga Sekretaria Mësimore për orarin, lëndët që do të zhvillojnë, detyrimet, strukturën e semestrit, etj. Gjithashtu, secili pedagog në prezantimin e lëndës/modulit shpjegon syllabusin, i cili përmban informacione rreth temave të përfshira, metodës së vlerësimit, aftësive që fiton studenti, etj. Informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara jepen dhe në webin zyrtar të IAL KUB: www.kub.edu.al.</p> |
| | <p><i>Evidenca:</i> <i>Dokumenti 3. Rregullore e programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 13. Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i></p> |

| | |
|--|--|
| | <p><i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>14. Rregullore sekretarie.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/</i> <i>A5.68 Elementet e Struktures se Programit te Studimit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | <p>Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se IAL KUB vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet/lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese (të cilat janë të përfshira tek planet mësimore dhe të bëra publike për studentët). Në bazë të dokumentave të shqyrtuara, IAL KUB ofron programin (i zhvilluar në gjuhën shqipe) e studimit të ciklit të dytë MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” me një kohëzgjatje 2 vite dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 120 kredite evropiane (ECTS) dhe u jepet diploma MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” (një vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë secili). Studentët mund të gjejnë informacion për lëndët/modulet dhe tek syllabuset e lëndëve/moduleve, si edhe duke aksesuar faqen web www.kub.edu.al, apo në rrjetet sociale.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>Dokumenti 3. Rregullore e programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 13. Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>14. Rregullore sekretarie.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/</i> <i>A5.68 Elementet e Struktures se Programit te Studimit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> | <p>GVJ, nga takimi me studentët dhe stafin e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës konstaton se informojnë studentët mbi mundësitë e punësimit dhe organizojnë takime dhe trajnime për studentët që i ndihmojnë ata për aplikime të suksesshme për punë. Kjo zyrë është në dispozicion të studentëve për këshillimin e karrierës, iu jep studentëve informacion rreth mundësive të ndryshme që IAL KUB në bashkëpunim me institucionet dhe kompanitë ofron për trajnime, praktika, mundësi punësimi, etj. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit që vijnë në institucion prej kompanive apo sipërmarrjeve përmes ofertave që ato dërgojnë, duke i shpallur këto njoftime në ambiente të dukshme të IAL KUB.</p> |

| | |
|---|--|
| | <p><i>Evidenca:</i> <i>Dokumenti 3. Rregullore e programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 13. Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/alumni/</i> <i>14. Rregullore sekretarie.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Departamenti i Menaxhimit (pjesë e Fakultetit të Ekonomisë në IAL KUB) së bashku me njësinë kryesore dhe koordinatoret e programeve organizojnë çdo vit takime informuese të përshtatjes së studentëve që regjistrohen në vitin e parë në programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” në IAL KUB. Studentët pas regjistrimit në institucion, në mënyrë periodike informohen prej zyrave përkatëse lidhur me aksesin në sistemin PORTAL KUB, adresën e tyre të emailit, etj. Nga takimi i GVJ me studentët, u konstatua se studentëve iu jepet një informacion i gjerë për aspektet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet, kohëzgjatjen e studimeve, planin mësimor, lëndët, mënyrat e vlerësimit, etj. Gjatë këtyre takimeve shpjegohen në detaje edhe struktura e IAL KUB, struktura e Fakultetit të Ekonomisë, prezantohen drejtuesit, stafi akademik, etj. Institucioni informon studentët në Javët e Hapura, si dhe informacion jepet në mënyrë të vazhdueshme dhe në faqen web të IAL KUB, në stendat e IAL dhe rrjetet sociale. Studentët kanë akses në faqen zyrtare web të IAL KUB (në kategorinë Studentët, ata gjejnë informacion për qeverinë studentore, konferencat studentore, aktivitetet sociale dhe sportive, alumni, orarin mësimor, kalendarin akademik, procesin e diplomimit dhe të punësimit, etj).</p> |
| | <p><i>Evidenca:</i> <i>Dokumenti 3. Rregullore e programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 13. Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergjithshme dhe specifike.pdf</i> <i>A1.13. Rregullore e Dep. Menaxhimit neni 6,7, dhe Organigrama KUB.pdf</i> <i>A5.67. Guida Studentore.pdf</i> <i>14. Rregullore sekretarie.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-fe/</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/</i> <i>Takimi i GVJ me studentët</i></p> |

| | | | | | | | | | |
|---|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p> | <p>Studentët marrin informacion të detajuar lidhur me programin e studimit nëpërmjet komunikimit që kanë me pedagogët dhe Sekretarinë Mësimore, nëpërmjet faqes zyrtare web të IAL KUB, si dhe nëpërmjet emaileve zyrtarë që posedojnë. Informacione të tjera të vlefshme bëhen të mundura nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, ato nëpërmjet botimeve dhe fletëpalosjeve (si dhe informacioneve të tjera të cilët studentët i aksesojnë në faqen web të KUB).</p> <p>Studentët e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” në IAL KUB aksesojnë sistemin PORTAL KUB përmes aksesit që ata kanë në emailin e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë (aksesimi është elektronik... mjafton që studenti të ketë akses në adresën e tij elektronike të mundësuar prej IAL KUB).</p> <p><i>Evidenca:</i> Sistemi Portal Kub Takimi i GVJ me studentët</p> | | | | | | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <tr> <td data-bbox="592 994 783 1068"></td> <td data-bbox="783 994 979 1068"></td> <td data-bbox="979 994 1203 1068">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1203 994 1412 1068">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td data-bbox="592 1068 783 1111"></td> <td data-bbox="783 1068 979 1111"></td> <td data-bbox="979 1068 1203 1111"></td> <td data-bbox="1203 1068 1412 1111">X</td> </tr> </table> | | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, GVJ konstaton se Sekretaria mësimore e fakultetit është përgjegjëse për mbajtjen e statistikave vjetore për numrin e studentëve në secilin program studimi, dhe numrin e të diplomuarve përkatës në këto programe studimi. Sekretaria mësimore e fakultetit i disponon këto statistika (në formë hard copy dhe në mënyrë elektronike), të cilat mblidhen dhe përpunohen në bazë të ligjit të arsimit të lartë nr.80/2015, udhëzimit të MASH nr.9, datë 25.02.2010 ‘Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore’, dhe udhëzimit të MASR, nr.16, datë 08.07.2019 ‘Për pajisjen e IAL publike dhe private me regjistrat bazë të studentëve’. Statistikat mblidhen si prej sekretarisë mësimore të fakultetit, ashtu dhe nga departamentet pas çdo sezoni diplomimi dhe u vihen në dispozicion strukturave drejtuese si dhe koordinatorit të programit të studimit. Në të njëjtën kohë këto statistika përfshihen edhe në raportet vjetore të fakultetit dhe institucionit. Për vitin akademik 2022-2023, 6 studentë po ndjekin programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>“Administrim Publik” (me notën mesatare në hyrje rreth 8), dhe 12 studentë atë me profil “Menaxhim Marketingu” (me notën mesatare në hyrje rreth 8.3).</p> <p><i>Evidenca:</i> A5.70 <i>Te dhenat statistikore diplomimi ne vite ne kete program studimi.pdf</i> 5. <i>Tabele per studentet (2021-2023).pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore të fakultetit, GVJ u njoh me statistikat që mbante kjo zyrë për programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, që përmbanin të dhëna në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të dhëna për të larguarit, transferimet, përqindjen e kalueshmërisë, etj. Ato përfshihen në raporte të ndryshme, si dhe deklarohen në MAS apo ASCAL.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023, 6 studentë po ndjekin programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik” (me notën mesatare në hyrje rreth 8; të diplomuar në vitin akademik 2021-2022, 2 studentë), dhe 12 studentë atë me profil “Menaxhim Marketingu” (me notën mesatare në hyrje rreth 8.3).</p> <p><i>Evidenca:</i> A5.70 <i>Te dhenat statistikore diplomimi ne vite ne kete program studimi.pdf</i> 5. <i>Tabele per studentet (2021-2023).pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga sekretaria mësimore e fakultetit, e cila synon të ruajë privatësinë dhe këto të dhëna iu vendosen në dispozicion vetëm personave të autorizuar (drejtuesit e IAL KUB, studentët, pedagogët, etj). Tek sekretaria mësimore e fakultetit gjendet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i notave, regjistri i lëshimit të diplomave, procesverbalet e notave, etj. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat ruhen në dokumenta fizikë dhe në mënyrë elektronike. Gjatë vizitës në IAL KUB, përfaqësues të sekretarisë mësimore të fakultetit i vunë GVJ në dispozicion regjistrin themeltar të studentëve për këtë program studimi i plotësuar sipas standardeve që kërkon ligji, si dhe procesverbale notash të lëndëve që përmban programi i studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Të dhënat (notat, etj) plotësohen edhe në sistemin PORTAL KUB, ku sekretaria i hedh ato (pas plotësimit manual të notave nga pedagogët).</p> <p><i>GVJ sugjeron që sistemi i hedhjes së notave të azhurnohet, nga ku vetë pedagogët t’i hedhin notat në sistem, kjo për të shkurtuar kohën dhe për të siguruar efektivitet të gjithë procesit.</i></p> |

| | |
|--|--|
| | <p><i>Evidenca:</i> A5.70 <i>Te dhenat statistikore diplomimi ne vite ne kete program studimi.pdf</i> 5. <i>Tabele per studentet (2021-2023).pdf</i> Sistemi Portal KUB</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p>IAL KUB mbështet me akte kontrollin periodik pranë sekretarisë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit (sistemit PORTAL KUB) etj., vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p><i>Evidenca:</i> Takimi me drejtues të IAL KUB</p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>Gjatë vizitës në IAL KUB, GVJ u informua se departamentet dhe sekretaria mësimore e fakultetit hartojnë raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Këto analiza dhe raporte që hartohen kryesisht nga Departamentet në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore (e cila kryesisht ndihmon me statistikën) vihen në shërbim të njësive dhe drejtuesve të IAL KUB për të bërë analiza e studime të mëtejshme dhe për të marrë masa përmirësimi në të ardhmen. Të dhënat mbledhen & përfshihen në raportet që përgatit departamenti, sekretaria, dhe fakulteti për strukturat drejtuese, dhe ku më pas i vihen në dispozicion edhe njësive të tjera (si NJSBC, etj) të cilat më pas i analizojnë dhe konkludojnë duke dhënë sugjerimet përkatëse.</p> <p>IAL KUB ka realizuar dhe një analizë mbi gjurmimin e studentëve, treguesve të punësimit të tyre. IAL KUB mban kontakte të vazhdueshme me studentët, duke ndjekur ecurinë, punësimin dhe arritjet e tyre, si dhe njësia kryesore mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre dhe organizon aktivitete të dedikuara për alumni (duke konsideruar eksperiencën e tyre) për të vlerësuar dijet dhe aftësitë që ata kanë marrë dhe do marrin gjatë periudhës së studimeve në IAL KUB.</p> <p><i>GVJ mendon që duhej një analizë e mirëfilltë e tregut të punës, ndër të tjera duke analizuar mundësitë e punësimit të studentëve të këtij programi, si dhe duke dhënë konkluzione & rekomandime për zhvillimin e programit në të ardhmen.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> A5.70 <i>Te dhenat statistikore diplomimi ne vite ne kete program studimi.pdf</i> 5. <i>Tabele per studentet (2021-2023).pdf</i> A5.69 <i>Treguesit e Punesimit.pdf</i></p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| Konkluzione | <p>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</p> <p>GVJ sugjeron që sistemi i hedhjes së notave të azhurnohet, nga ku vetë pedagogët t'i hedhin notat në sistem, kjo për të shkurtuar kohën dhe për të siguruar efektivitet të gjithë procesit.</p> <p>GVJ mendon që duhej një analizë e mirëfilltë e tregut të punës, ndër të tjera duke analizuar mundësitë e punësimit të studentëve të këtij programi, si dhe duke dhënë konkluzione & rekomandime për zhvillimin e programit në të ardhmen.</p> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi V.5 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> | <p>IAL KUB parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas ligjit të arsimit të lartë nr. 80/2015 dhe akteve rregullatore të IAL_{se}. Në bazë të Statutit të KUB, studentët kanë të drejtë të zgjidhen në Senatin Akademik, dhe në Këshillat (qeverinë) studentore (zgjidhen çdo 2 vite nga votat e studentëve), që janë organizime të pavarura të studentëve (nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike) dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidenca:</i> A5.75 Vendim per emerim ne senat te perfaqesuesve te qeverise studentore.pdf Dok 1. Rregullore te pergj.dhe specifike.pdf Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/#qeveria_studentore STATUTI I KUB RVB e IAL KUB</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>Bazuar në vizitën në IAL KUB dhe takimin me studentët, GVJ u informua se nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar vazhdimisht në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të IAL KUB. Departamenti i Menaxhimit, dhe Njësia Kryesore i mirëpresin sugjerimet dhe vërejtjet e studentëve për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe marrëdhënien me IAL_{ne}. IAL KUB garanton se përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillimin apo vlerësimin e procesit mësimor është reale dhe studentët konkretisht përfaqësohen në Senatin Akademik, si dhe janë përfshirë në procese vlerësimesh të brendshme, mobilitete, vlerësimin e stafit akademik, etj. Studentët përfaqësohen në Këshillat (qeverinë)</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>studentore, ku zgjidhen çdo 2 vite nga votat e studentëve. Ata kanë hapësirën e tyre në faqen web të IAL KUB: www.kub.edu.al, tek kategoria Studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A5.75 Vendim per emerim ne senat te perfaqesuesve te qeverise studentore.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergj.dhe specifike.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/#qeveria_studentore</i> <i>A1.5 Urdher Rektori per ngritjen e GVB.pdf</i> STATUTI I KUB RVB e IAL KUB</p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p> | <p>Në bazë të takimit me drejtuesit dhe studentë të IAL KUB, GVJ konstaton se IAL garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Njëpërmjet anëtarëve të këshillave (qeverisë) studentore apo studentëve anëtarë të senatit, përcillen kërkesat apo sugjerimet e studentëve në nivelet drejtuese të të gjitha niveleve. Studentët janë të përfshirë gjithashtu në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e programeve të ndryshme të studimit.</p> <p>IAL KUB organizon takime periodike me Këshillin Studentor, Fokus Grupe me studentët, si dhe organizon pyetësorë nëpërmjet NjSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) për vlerësimin e programeve të studimit dhe stafit akademik, (si dhe nëpërmjet bërjes së takimeve dhe anketimeve të rregullta), dhe më pas përpunimin e pyetësorëve të studentëve ku studentët mund të japin komente për ato fusha ku ka nevojë për përmirësime të procesit. Në këtë mënyrë studentëve u jepet mundësia të komentojnë lidhur me pedagogët dhe problematikat e hasura gjatë zhvillimit të programit të studimit. Në fund, krijohen raporte, të cilat diskutohen konkretisht në mbledhjet e Departamentit të Menaxhimit për të marrë masat përkatëse lidhur me këtë programi studimi.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Dokumenti 3 – Rregullore e programit MSC MB.pdf</i> <i>4. Pyetsori studentit (formati).pdf</i> <i>A5.75 Vendim per emerim ne senat te perfaqesuesve te qeverise studentore.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergj.dhe specifike.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/#qeveria_studentore</i> <i>A1.5 Urdher Rektori per ngritjen e GVB.pdf</i></p> |

| <p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësishë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>Bazuar në takimin me studentët (për vitin akademik 2022-2023, 6 studentë po ndjekin programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik”, dhe 12 studentë atë me profil “Menaxhim Marketingu”), GVJ u informua se atyre iu mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, iu jepet mundësia të vlerësojnë performancën e stafit akademik në të gjitha aspektet e procesit mësimor. Studentët e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” njihen me pikët e marra gjatë semestrit dhe me rezultatin e provimit pas zhvillimit të provimit. Elementët kryesorë të vlerësimit përfshijnë: provimet, detyrat në grup, aktivizimin në seminare, provimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, provimin përfundimtar, etj.</p> <p>Studentët pohuan se iu jepet e drejta të ankohen për shkelje të rregullave të provimit, gabime ose pasaktësi në provim, ku ankesa me shkrim dorëzohet tek sekretaria mësimore brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultateve të provimit. Sekretaria mësimore, këto ankesa/kërkesa ia përcjell departamentit përkatës, i cili nga ana e tij ngre një komision enkas për këto raste. Pas shqyrtimit nga ana e komisionit, departamentet dorëzojnë pranë sekretarisë mësimore qëndrimet e komisionit për çdo kërkesë, të cilat më pas sekretaria jua komunikon studentëve.</p> <p>GVJ i pyeti drejtuesit dhe studentët për mënyrën e funksionimit të procedurës së ankimimit të studentëve për rezultatet e provimit, dhe ata u shprehën të kënaqur për procesin.</p> <p><i>Evidenca:</i> Dok 13. Rregulloret e provimeve, kriteret dhe procedurat e diplomimit.pdf 12. Vendimi krijimit të NJSBC.pdf A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf A6.73 Raporti i veprimtarisë NJSBC.pdf Dokumenti 3 – Rregullore e programit MSC MB.pdf 4. Pyetori studentit (formati).pdf A5.75 Vendim për emerim në senat të përfaqësuesve të qeverisë studentore.pdf Dok 1. Rregullore të përgj dhe specifike.pdf Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/#qeveria_studentore RVB e IAL KUB</p> | | | | | | | | |
|--|--|-----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|--|--|--|----------|
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1787 778 1861">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="778 1787 981 1861">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="981 1787 1198 1861">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1198 1787 1417 1861">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1861 778 1897"></td> <td data-bbox="778 1861 981 1897"></td> <td data-bbox="981 1861 1198 1897"></td> <td data-bbox="1198 1861 1417 1897" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.

IAL KUB ka njësi e procedura të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL KUB. Zyrat e sekretarisë mësimore, e rektorit, e administratorit, kanë për detyrë që të mbështesin studentin dhe të informojnë sipas përcaktimeve ligjore që lidhen ngushtësisht me statusin e studentit. Janë të përfshirë edhe koordinatorët e programeve të studimit të cilët përmes eksperiencës që kanë si dhe njohjes së mirë të programeve mësimore këshillojnë studentët mbi informacione të ndryshme që ata kërkojnë lidhur me programin e studimit. IAL KUB ka dhe struktura mbështetëse në shërbim të studentëve dhe informimit të tyre të tilla si: Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Departamenti në bashkëpunim me stafin e zyrës së këshillimit të karrierës, këshillon dhe orienton studentët lidhur me përzgjedhjen e kompanive për zhvillimin e praktikës profesionale si dhe përzgjedhjen e temave të diplomave. Gjithashtu, studentët informohen dhe nga webi zyrtar i IAL KUB, apo nëpërmjet emaileve zyrtare & në rrjetet sociale.

Evidenca:

13. Vendim per kordinatorin e ketij programi studimi.pdf

A5.75 Vendim per emerim ne senat te perfaqesuesve te qeverise studentore.pdf

Dok 1. Rregullore te pergj.dhe specifike.pdf

Linku: <https://kub.edu.al/studentet-2/>

STATUTI I KUB

RVB e IAL KUB

Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, ajo e burimeve njerëzore, & sekretaria mësimore asistojnë studentin që nga regjistrimi deri në diplomim, ofrojnë informacione e këshillim për çështje të lidhura me procesin mësimor dhe përfshirjen e studentëve në tregun e punës, vendin ku do të kryejnë praktikën, përzgjedhjen e karrierës, etj. Një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe informimin e studentëve ka Departamenti i Menaxhimit (përgjegjës për këtë program studimi), ku stafi akademik përkatës i ndihmon studentët për çdo nevojë apo problematikë që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Koordinatorët e programeve të studimit luajnë rol të rëndësishëm ku përmes eksperiencës që kanë si dhe njohjes së mirë të programeve mësimore këshillojnë studentët mbi informacione të ndryshme që ata kërkojnë lidhur me PS. Gjithashtu informimi i studentëve bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të web-it të IAL KUB: www.kub.edu.al.

| | |
|---|---|
| | <p><i>Evidenca:</i> <i>A4.53 Organigrama KUB.pdf</i> <i>13. Vendim per kordinatorin e ketij programi studimi.pdf</i> <i>A5.75 Vendim per emerim ne senat te perfaqesuesve te qeverise studentore.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergj.dhe specifike.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/</i> STATUTI I KUB RVB e IAL KUB <i>Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>IAL KUB ka ngritur struktura mbështetëse në shërbim të studentëve dhe informimit të tyre të tilla si Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila mirëpret studentët duke iu ofruar informacione dhe orientim të posaçëm në lidhje me programet mësimore, ciklet e studimit, karrierën, praktikat profesionale, kërkesat e tregut të punës, etj. Staf i kësaj zyre informon kandidatët dhe studentët e IAL lidhur me programet mësimore, ciklet, procedurat dhe afatet e regjistrimit të tyre. Kjo zyrë bashkëpunon në rastin konkret me Departamentin e Menaxhimit për organizimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi, organizon panairt e punës, mban marrëdhënie me studentët e diplomuar/alumni, organizon seminare, etj. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës iu jep studentëve informacion mbi mundësitë e karrierës dhe punësimit, akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, njohjen e krediteve etj, si dhe ruan lidhje të ngushta me Këshillin (qeverinë) Studentor për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të studentëve. Të dyja këto njësi bashkëpunojnë dhe me sekretariatë mësimore & NJSBC, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A4.53 Organigrama KUB.pdf</i> <i>13. Vendim per kordinatorin e ketij programi studimi.pdf</i> <i>A5.75 Vendim per emerim ne senat te perfaqesuesve te qeverise studentore.pdf</i> <i>Dok 1. Rregullore te pergj.dhe specifike.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/studentet-2/</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/njsbc/</i> <i>Linku: https://kub.edu.al/alumni/</i> RVB e IAL KUB <i>Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it</i></p> |

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.

Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës në IAL KUB ka si detyrë të grumbullojë informacione mbi të diplomuarit dhe të përgatisë raporte për shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. Kjo zyrë në bashkëpunim me struktura të tjera institucionale si sekretariatë mësimore & NJSBC, etj, ndjek aktivitetet e zhvilluara prej studentëve dhe njëkohësisht pas përfundimit të studimeve prej tyre, ndjek dhe ecurinë e punësimit dhe zhvillimit të tyre të karrierës (si dhe përgatit të dhëna dhe i prezanton ato për analiza të mëtejshme). Për studentët e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” mbahen të dhënat e kontakteve të tyre (emaile, numrat e telefonit, shkollimi, kompanitë/organizatat ku janë të punësuar, pozicionet e punës, etj), dhe sipas drejtuesve të IAL KUB, do të mbeten në kontakt me studentët edhe pas përfundimit të studimeve të tyre, pasi studentët janë ura lidhëse midis programit të studimit dhe tregut të punës.

Evidenca:

A4.53 Organigrama KUB.pdf

Alumni KUB_000083.pdf

A2.27 Te dhenat e punesimit te studenteve ne KUB.pdf

Dok 1. Rregullore te pergj.dhe specifike.pdf

12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf

A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf

A6.73 Raporti i veprintarise NJSBC.pdf

Linku: <https://kub.edu.al/studentet-2/>

Linku: <https://kub.edu.al/alumni/>

RVB e IAL KUB

Konkluzione

GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet kryesisht | | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------------|--|-----------------------|
| | | | |
| | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Përmbushet kryesisht | | Përmbushet plotësisht |
|--|----------------------|--|-----------------------|
| | | | |
| | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi VL1 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, si dhe informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL KUB i ka kushtuar rëndësi përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. IAL KUB për të lehtësuar punën e stafit akademik dhe për të rritur cilësinë në edukim, në procesin e mësimdhënies ka standardizuar politikat dhe metodat e mësimdhënies. Departamenti i Menaxhimit në Fakultetin e Ekonomisë në KUB e ka formalizuar përdorimin e mjeteve didaktike dhe metodave e teknikave bashkëkohore në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies interaktive. Është krijuar dhe NJSBC (të formalizuara tek Statuti & Rregullorja e NJSBC) e cila vlerëson periodikisht veprimtaritë mësimore dhe kërkimore-shkencore, dhe mbi bazën anketimeve jepen sugjerime lidhur me përmirësime të mundshme lidhur me metodat e mësimdhënies, literaturën e përdorur, etj. Gjatë kohës së pandemisë Covid-19 u hartuar dhe një rregullore për zhvillimin e procesit të mësimin online. Lidhur me programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu” metodat e mësimdhënies janë në ndryshim të vazhdueshëm. Një ndër dokumentet më të rëndësishme lidhur me udhëzimet në nivel institucional është dhe strategjia e zhvillimit e KUB, ku jepet vizioni, misioni, strategjia dhe objektivat e tij, etj. KUB ka organizuar seminare/workshope me pedagogët për trajnimin e tyre në varësi të fushës së studimit, lidhur me mësimdhënien dhe zhvillimin e kompetencave pedagogjike.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit të procesit mësimor online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>12. Vendimi krijimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit të programit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar (Statuti i KUB, Rregullorja e NJSBC, Rregullorja e programit të studimit, etj), GVJ konstaton se IAL KUB ka ngritur struktura që janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Monitorimi dhe vlerësimi përfshijnë aktorë në rang fakulteti dhe në rang institucional. Në rang fakulteti procesi i monitorimit dhe vlerësimit bëhet në përputhje të përbushjes së objektivave të fakultetit të vendosur në fillim të çdo viti akademik dhe të miratuara prej Senatit Akademik. Në rang institucional në funksion të sigurimit të cilësisë në IAL KUB është ngritur Njësia e</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, e cila në bashkëpunim me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit e realizojnë këtë detyrë duke vlerësuar periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore nëpërmjet kontrolleve, relacioneve të lëndëve, pyetësorëve të studentëve, dhe duke hartuar relacione që propozojnë ndryshime për përmirësime potenciale. NJSBC harton kalendarin e kontrollit të cilësisë për personelin akademik të IAL KUB për të gjithë programet e studimit të ofruara, si dhe harton çdo vit raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në KUB. Vlerësimi i stafit akademik kryhet nëpërmjet raportimeve për përmbushjen e detyrave dhe objektivave; vetëvlerësimit të aktivitetit të tyre; vlerësimit prej strukturave menaxhuese të njësisë kryesore. IAL KUB i ka kushtuar rëndësi monitorimit dhe vlerësimit të edukimit, rritjes së cilësisë në zbatimin e standardeve institucionale si dhe proceseve akademike. Gjithashtu, rol ka luajtur dhe Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) ku nëpërmjet pyetësorëve të kryer, ka bërë analizën përkatëse për vlerësimin e studentëve, vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e personelit akademik, etj, dhe në fund janë dhënë dhe përfundimet & sugjerimet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit të procesit mësimor online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>12. Vendimi krijimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit të programit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p> | <p>Bazuar në Statutin e IAL KUB, është ngritur NJSBC si strukturë e brendshme e përhershme, e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC përbëhet nga 6 anëtarë (ku përfshihet dhe 1 student). NJSBC organizon plotësimin e pyetësorëve në mënyrë anonime nga studentët (pyetësori zhvillohet fizikisht dhe organizohet dy herë në vit) për vlerësimin periodik të formave të metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë dhe mundësinë e trajtimit të ankimeve. NJSBC miraton për çdo vit formatin template të pyetësorit që do të organizohet për studentët e çdo cikli studimi. Studentëve iu mundësohen nga IAL dhe takime me stafin akademik dhe administrativ në prani të NJSBC, ku mund të shprehin opinionet e tyre lidhur me procesin mësimor, si dhe ankesa potenciale që mund të kenë. Të dhënat përpunohen nga NJSBC dhe i dorëzohen instancave përgjegjëse me synim përmirësimin e cilësisë, rritjen e zbatimit të standardeve të kërkuara si dhe arritjes së objektivave të institucionit.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i></p> <p><i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i></p> <p><i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i></p> <p><i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>NJSBC është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe duke i bërë publike rezultatet e vlerësimit. NJSBC harton kalendarin e kontrollit të cilësisë për personelin akademik të KUB për të gjithë programet e studimit të ofruara, si dhe harton çdo vit raportin vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në IAL KUB, raport i cili i vihet në dispozicion Rektorit dhe çdo pale të përfshirë në procesin e vlerësimit (Dekanët e fakulteteve, etj; si dhe njofton personalisht pedagogët për vlerësimin e tyre nga studentët). Tek NJSBC përfshihen dhe studentë, si palë kryesore e gjithë procesit për cilësi më të mirë. Pyetësorët kanë shërbyer si një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe zhvillimet institucionale, sesi janë perceptuar këto ndryshime prej studentëve, për cilësinë e punës së secilit pedagog, etj. Gjithashtu, Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) nëpërmjet pyetësorëve të kryer, ka bërë analizën përkatëse për vlerësimin e studentëve, vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e personelit akademik, etj, dhe në fund janë dhënë dhe përfundimet & sugjerimet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i></p> <p><i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i></p> <p><i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i></p> <p><i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i></p> <p><i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i></p> |
| | <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> |

| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>IAL KUB në bashkëpunim me NjSBC (e cila harton çdo vit planin e veprimtarive kryesore), në bazë të raportit vjetor të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në KUB & në rezultatet dhe statistikën e tij, nxjerr konkluzione dhe rekomandime, si dhe planin e masave lidhur me përmirësimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies, për inkurajimin e personelit akademik, etj. Njësitë kryesore mund të promovojnë jo vetëm stafin e tyre, por edhe praktikën e mira dhe shembujt që nxisin tek studentët dhe stafi përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në takimin me drejtuesit e KUB, GVJ u informua që në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimeve, diskutohen krahas problematikave, edhe praktikat më të mira të evidentuara, duke i promovuar ato me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. Një rol të rëndësishëm në monitorimin e procesit mësimor ka edhe Departamenti i Menaxhimit, ku Përgjegjësi i këtij departamenti na informoi se në fillim të vitit akademik hartohet plani i punës për personelin akademik për vlerësimin e performancës së stafit akademik, në të cilin përfshihet përveç të tjerave edhe vlerësimi për mësimdhënien. Gjithashtu, Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me NjSBC organizojnë kontrole periodike për mënyrën e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve në auditor për të siguruar një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimor. IAL KUB në mënyrë promovuese dhe të vazhdueshme ka vlerësuar stafin dhe studentët për arritjet e tyre si në procesin mësimor, ashtu dhe për arritje në aktivitete të lidhura me kompeticione, projekte, etj.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>12. Vendimi krijimit të NJSBC.pdf</i></p> <p><i>A6.73 Raporti i veprimtarisë NJSBC.pdf</i></p> <p><i>A6.80 Pyetësori Muaji Janar 2023.pdf</i></p> <p><i>4. Pyetësori studentit (formati).pdf</i></p> <p><i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i></p> <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit të procesit mësimor online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit të programit.pdf</i></p> | | | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|----------|
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</i></p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1697 778 1776">Përcaktuar</th> <th data-bbox="778 1697 981 1776">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="981 1697 1184 1776">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1776 778 1816"></td> <td data-bbox="778 1776 981 1816"></td> <td data-bbox="981 1776 1184 1816" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | Përcaktuar | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| Përcaktuar | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> | <p>IAL KUB ka politika dhe struktura për sigurimin e cilësisë, të tilla si Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC), si strukturë kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë të arsimit të lartë, udhëzimet e ASCAL, Statutin dhe rregullore të tjera. NjsBC është njësi përgjegjëse për zbatimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, dhe synon garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të IAL KUB. Statuti i IAL KUB dhe Rregullorja e NjsBC përcaktojnë qartë parimet e funksionimit dhe ato mbi të cilat ngrihet dhe mbështetet puna e NjsBC për sigurimin e cilësisë, strukturë e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NjsBC është organ kolegjal dhe përbëhet nga 6 anëtarë (ku përfshihet dhe 1 student). NjsBC vlerëson dhe raporton periodikisht pranë Rektorit rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të IAL në aspektin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë (Rektori emëron dhe shkarkon drejtuesin e NjsBC).</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC</i> <i>RVB e IAL KUB</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> <i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e</p> | <p>IAL KUB ka ndjekur një strategji institucionale lidhur me sigurimin e cilësisë në institucion, sigurim cilësie që ka pasur karakter gjithëpërfshirës si nga stafi akademik, ashtu dhe nga studentët, dhe është shoqëruar me kërkesa gjithnjë në rritje ku nga secili punonjës kërkohet</p> |

| | |
|--|---|
| <p>vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm. GVJ konstaton që IAL KUB ka ngritur strukturën për sigurimin e cilësisë, konkretisht Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) nëpërmjet të cilës zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, dhe ka një sistem funksional. NJSBC monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetësorit të stafit akademik (si dhe fokus grupet me studentët) dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj. Qëllimi kryesor i NJSBC_{se} është që nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative të sigurohet rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ mendon që duhej më shumë informacion se cilët janë bashkëpunëtorët/ekspertët e jashtëm dhe se si përfshihen ata.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NJSBC RVB e IAL KUB</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> <i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se IAL KUB përdor instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë. IAL KUB përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse (përdor pyetësorë fizikë si dhe fokus grupet me studentët) për sigurimin e cilësisë në institucion si dhe për të ndjekur ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit, proces i cili organizohet nga NJSBC për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe ku rezultatet e tyre i raportohen Rektorit. NJSBC jep rekomandime mbi përmirësimin e hapave që duhen ndjekur për të qenë në koherencë të plotë me zbatimin e kërkesave të MAS si dhe atyre në lidhje me përmbushjen e procedurave që duhet të ndiqen për akreditimin e programeve të studimit. NJSBC bashkëpunon ngushtësisht me ASCAL duke marrë pjesë jo vetëm në trajnimet dhe takimet e</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>organizuara prej tyre rreth cilësisë, standardeve dhe proceseve të vlerësimit, por edhe duke organizuar takime me natyrë informuese dhe sqaruese për proceset e vetëvlerësimit, etj. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë kryhet nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Gjithashtu, edhe Instituti për Cilësi në Arsim (IQE) nëpërmjet pyetësorëve të kryer, ka bërë analizën përkatëse për vlerësimin e studentëve, vlerësimin e mësimdhënies, vlerësimin e personelit akademik, etj, dhe në fund ka dhënë dhe përfundimet & sugjerimet përkatëse.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC RVB e IAL KUB</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> <i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p> | <p>IAL KUB përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie & kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, IAL KUB bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit, e cila bëhet gjatë mbledhjeve periodike të drejtuesve me stafin dhe studentët me synim që këto shembuj pozitivë të shërbejnë si benchmark edhe për programet e tjera të studimit.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC RVB e IAL KUB</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i></p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</i></p> <p><i>GVJ mendon që duhej më shumë informacion se cilët janë bashkëpunëtorët/ekspertët e jashtëm dhe se si përfshihen ata.</i></p> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi VL3 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>GVJ, në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit, përgjegjës për programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, u informua se në fillim të çdo viti akademik kërkohen nga stafi akademik mendime apo sugjerime në lidhje me përditësimin e syllabuseve dhe miratohen ndryshimet e mundshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, në përfundim të çdo semestri, Departamenti i Menaxhimit diskuton dhe analizon raportet e krijuara nga rezultatet e pyetësorëve/anketav të studentëve dhe pedagogëve që realizohen nga NjSBC e IAL KUB. Kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik është në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore, që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve. Kontrolli realizohet nëpërmjet vlerësimit të çdo pedagogu dhe lënde nga vetë studentët, vetëvlerësimit të performancës nga çdo pedagog, vlerësimit prej eprorëve respektivë të punës së realizuar nga pedagogët, dhe vlerësimit administrativ për aspekte të tilla si respektimi i orarit, niveli i shfrytëzimit të orës së mësimi, korrektësia e çdo pedagogu, etj. Shumë aktivitete dhe procedura realizohen bashkërisht nga personeli akademik dhe ai ndihmës, me koordinimin e strukturës administrative të institucionit.</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve të pyetësorëve përpunohen prej njësive përkatëse dhe në fund përpilohen raporte (me tabela, shifra e të dhëna) nga NjSBC, dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, konkretisht Rektorit (kurse në mënyrë konfidenciale të gjithë stafit të IAL KUB). Në</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>raportet që hartohen jepet informacion mbi problematika të ndryshme të hasura që kanë lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe rekomandimet përkatëse për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre. Në raport përfshihet edhe baza ligjore mbi të cilën mbështetet anketimi i studentëve si dhe metodologjia e hartimit të raportit. IAL KUB synon që të jetë transparent dhe të informojë studentët, stafin si dhe të gjitha palët e interesuara mbi ecurinë e procesit mësimor në institucion.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC RVB e IAL KUB</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> <i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> | <p>NjsBC harton raportet e vlerësimit, të cilat përfshijnë vlerësimin e situatës, kryesisht të gjërave që kanë lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe jepen masat që duhen marrë nga departamentet apo njësitë përkatëse të tjera për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e elementëve të duhura që nuk janë siç duhet. Departamentet bëjnë analizën e tyre vjetore dhe hartojnë një raport me të gjithë elementët përkatës, duke përfshirë stafin akademik, strukturën mësimore, studentët, bashkëpunimin me IAL të tjera dhe më njësi të tjera në IAL KUB, etj, si dhe vendosen objektivat për të ardhmen. Njëkohësisht një formë e vlerësimit sidomos për stafin akademik është edhe vlerësimi i tij prej strukturave përgjegjëse e drejtuese në fund të çdo vitit akademik. Njësitë kryesore dhe ato bazë i analizojnë konkluzionet me stafet e tyre akademike dhe ndërmarrin veprime me hapa konkretë për ndryshimin e situatës apo përmirësimin e saj.</p> |
| | <p><i>Evidenca:</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC</i></p> |

| | |
|--|---|
| | <p><i>RVB e IAL KUB</i></p> <p><i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i></p> <p><i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i></p> <p><i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i></p> <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>Njsbc në IAL KUB realizon vlerësimin e programit të studimit, të planeve mësimore, të syllabuseve në lidhje me objektivat, përputhshmërinë e tyre me përmbajtjen e lëndëve/moduleve, shpërndarjen e ngarkesës së orëve gjatë vitit akademik për stafin akademik, ngarkesën e orëve për studentët, vlerësimin e materialeve didaktive, etj. Bëhet vlerësimi i performancës së stafit akademik nëpërmjet të cilit vlerësohen hartimi i leksioneve të reja, përditësimi i syllabusit dhe literaturës, niveli i kërkimit shkencor, etj. Instrumenta të tjera janë edhe metodat e monitorimit e drejtpërdrejta gjatë procesit të mësimin, vlerësimi i kontrollit të provimeve, kontrolli i procesverbaleve, etj. Metodatat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit përfshijnë: takimet e autoriteteve drejtuese me studentët dhe me Këshillin (qeverinë) Studentor, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testimeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve të një programi, etj. Përdoren dhe sondazhet e studentëve që ndjekin programin e studimit, sondazhet e vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, dhe fokus grupet me studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i></p> <p><i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i></p> <p><i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i></p> <p><i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i></p> <p><i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Takimi në IAL KUB me stafin e Njsbc</i></p> <p><i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i></p> <p><i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i></p> <p><i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i></p> <p><i>Statuti i KUB</i></p> <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i></p> <p><i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i></p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i> | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p> | <p>NJSBC kryen sondazhe dhe intervista me studentët & takime me stafin akademik të PS në lidhje me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe mundësitë potenciale për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Bëhen takime dhe me stafin ndihmës akademik dhe administrativ të IAL KUB në mënyrë që mendimet e tyre të reflektohen në vendimmarrjet e ardhshme nga ana e drejtuesve të IAL KUB. Metodatat e tërthorta të përdorura në procesin e vlerësimit përfshijnë raportet vjetore dhe raportet e vlerësimit të programit dhe raportet e vlerësimit prej strukturave drejtuese; vetëvlerësimi i stafit akademik; Raportet e Vlerësimit të Brendshëm & Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për proceset e akreditimit të programeve; vlerësimet nga studentët Alumni; etj. IAL KUB ka krijuar një databazë me të dhënat dhe kontaktet e studentëve për të ruajtur komunikimin në të ardhmen në interes të ndërsjelltë.</p> <p><i>Evidenca:</i> 4. Pyetësi studentit (formati).pdf 12. Vendimi krijimit të NJSBC.pdf A6.73 Raporti i veprimtarisë NJSBC.pdf A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf Takimi në IAL KUB me stafin e NJSBC A6.80 Pyetësor Muaji Janar 2023.pdf Dok 5. Strategjia e zhvillimit të programit.pdf A6.79 Raporti i IQE.pdf Statuti i KUB A3.43 Rregullorja e zhvillimit të procesit mësimor online.pdf Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</p> | | |
| Konkluzione | GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi VI.4 | |
|---|---|
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar si dhe nga informacionet e marra gjatë vizitës në IAL KUB, GVJ konstaton përfshirjen e aktorëve të brendshëm në strukturat e ngritura për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të veta të studimit. Në strukturën e NjsBC dhe GVB janë përfshirë anëtarë përfaqësues të stafit akademik, por duke përfshirë dhe përfaqësues të studentëve. Sipas drejtuesve të IAL, institucioni dhe njësitë kryesore kanë angazhuar ekspertë të jashtëm në vlerësimin e programeve të studimit, ashtu siç dhe kanë marrë mendimin dhe opinionin e ekspertëve nga institucionet, biznesi dhe sipërmarrja në takimet e organizuara me qëllim përmirësimin e programit të studimit ose të programeve të lëndës. Në lidhje me studentët, IAL KUB i ka përfshirë edhe në Senatit Akademik, Këshillin e Etikës dhe GVB, me synim që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh nga institucioni. Gjithashtu, është kontraktuar dhe Instituti për Cilësi në Arsim (IQE), ku nëpërmjet pyetësorëve të kryer, ka bërë analizën përkatëse dhe në fund ka dhënë dhe përfundimet & sugjerimet.</p> <p><i>GVJ mendon që duhej më shumë informacion se cilët janë bashkëpunëtorët/ekspertët e jashtëm dhe se si përfshihen ata.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A5.77 Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> <i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë</p> | <p>Në IAL KUB, për sigurimin e brendshëm të cilësisë është ngritur NjsBC (e krijuar me vendim të Senatit Akademik; bën pjesë dhe 1 student tek NjsBC), ku krijimi, organizimi dhe funksionimi janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e NjsBC. Ajo bashkëpunon me departamentet</p> |

| | |
|--|--|
| <p>së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>dhe me njësitë e tjera në mënyrë të vazhdueshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe përmirësimin e PS. Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e NjsBC. Nga ana tjetër, procedura për përmirësimin e cilësisë (ashtu si rregullorja e cilësisë) përcaktojnë dhe njësitë bazë/departamentet.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC</i> <i>A5.77 Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> <i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p> | <p>NjsBC e IAL KUB ka përbërje institucionale duke përfshirë përfaqësues prej njësisë kryesore të IAL. Nga hulumtimi i dokumentave dhe takimi me drejtues të IAL KUB, shihet se ai garanton përfshirjen e drejtpërdrejtë të njësisë bazë dhe asaj kryesore përgjegjëse për programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë, duke siguruar një bashkëpunim të vazhdueshëm të NjsBC, me departamentet dhe studentët. Janë përfshirë stafi akademik, të cilët me anë të mendimeve, sugjerimeve apo nevojave të tyre, kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të këtij programi studimi. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit përfshihen të gjithë aktorët kryesorë në rang njësie bazë dhe kryesore; anëtarët e personelit akademik dhe studentët e programit të studimit. Në rastin konkret, studentët janë pjesë dhe e GVB për vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p><i>GJV mendon që duhet më shumë informacion mbi përfshirjen e përfaqësuesve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ tek NjsBC.</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <p><i>Evidenca:</i> 12. <i>Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> 4. <i>Pyetesori studentit (formati).pdf</i> A6.73 <i>Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> A6.72 <i>Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NJSBC</i> A5.77 <i>Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> A6.80 <i>Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> Dok 5. <i>Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i> A6.79 <i>Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> A3.43 <i>Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> Dokumenti 3 - <i>Rregullore programit MSC MB.pdf</i> A5.78 <i>Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, GVJ konstaton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektuar integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Sipas tyre, gjatë zhvillimit të pyetësorëve është ruajtur anonimati dhe integriteti akademik, si dhe duke respektuar parimet e etikës, të cilat janë të detyrueshme për tu ndjekur për të gjithë palët e përfshira. Sipas drejtuesve të IAL KUB, nuk kanë patur asnjë rast të ngritur ose të regjistruar të diskriminimit apo pabarazisë së ushtruar ndaj personelit ose studentëve.</p> <p><i>Evidenca:</i> A6.72 <i>Rregullore e NJSBC.pdf</i> 12. <i>Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> 4. <i>Pyetesori studentit (formati).pdf</i> A6.73 <i>Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NJSBC</i> A5.77 <i>Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> A6.80 <i>Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> Dok 5. <i>Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i> A6.79 <i>Raporti i IQE.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i></p> |
| | |

| | | | |
|---|---|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> | | |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>Në takimin me drejtues të IAL KUB, ata specifikojnë që në procesin e vlerësimit, Fakulteti i Ekonomisë i IAL KUB ka përfshirë aktorë apo bashkëpunëtorë të jashtëm, dhe ka zhvilluar takime të ndryshme me institucione dhe sipërmarrje në mënyrë që të vlerësohet qëndrueshmëria e programit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”, përshtatja e njohurive me tregun e punës etj. Gjithashtu, është kontraktuar dhe Instituti për Cilësi në Arsim (IQE), ku nëpërmjet pyetësorëve të kryer, ka bërë analizën përkatëse dhe në fund ka dhënë dhe përfundimet & sugjerimet.</p> <p><i>GVJ mendon që duhej më shumë informacion se cilët janë bashkëpunëtorët/ekspertët e jashtëm dhe se si përfshihen ata.</i></p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>4. Pyetësi studentit (formati).pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NJSBC</i> <i>A5.77 Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> <i>A6.80 Pyetësor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>Dok 5. Strategjia e zhvillimit te programit.pdf</i> <i>Statuti i KUB</i> <i>A3.43 Rregullorja e zhvillimit te procesit mesimore online.pdf</i> <i>Dokumenti 3 - Rregullore programit MSC MB.pdf</i> <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</i></p> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. | |
|--|--|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>GVJ u informua gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC se kjo njësi i bën transparente dhe i vë në dispozicion të të gjithë pjestarëve në IAL KUB (stafit akademik dhe studentëve) politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e tjera në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Informacioni përcillet në institucion nëpërmjet departamenteve tek stafi dhe studentët nëpërmjet shkresave zyrtare apo raporteve të hartuara nga NJSBC. NJSBC publikon raporte, manualë, si dhe vlerësime që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët.</p> <p><i>Evidenca:</i> 12. <i>Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> A6.79 <i>Raporti i IQE.pdf</i> A6.72 <i>Rregullore e NJSBC.pdf</i> 4. <i>Pyetësi studentit (formati).pdf</i> A6.73 <i>Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NJSBC</i> A5.77 <i>Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> A6.80 <i>Pyetësor Muaji Janar 2023.pdf</i> A5.78 <i>Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>IAL KUB i publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit që NJSBC realizon, dhe i shpërndan në të gjitha nivelet brenda institucionit. GVJ konstaton se publikimi i të gjitha dokumentave dhe informacioneve (nga pyetësorët/anketat, etj) bëhet duke respektuar, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidenca:</i> 12. <i>Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> A6.79 <i>Raporti i IQE.pdf</i> A6.72 <i>Rregullore e NJSBC.pdf</i> 4. <i>Pyetësi studentit (formati).pdf</i> A6.73 <i>Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NJSBC</i> A5.77 <i>Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> A6.80 <i>Pyetësor Muaji Janar 2023.pdf</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <p><i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që NjsBC i analizon rezultatet e vlerësimit, dhe në bazë të këtyre rezultateve ajo ka nxjerrë konkluzione dhe ka dhënë rekomandime e plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive që janë evidentuar. Vlerësimet që kanë të bëjnë me programin e lëndës, si dhe me programin e studimit, mësimdhënien apo literaturën etj., shoqërohen prej komenteve, vërejtjeve nëse ka të tilla, nga të cilat rrjedhin edhe masat që njësia bazë dhe ajo kryesore marrin parasysh dhe adresojnë për zgjidhje tek stafi akademik, ndihmës akademik, administrativ, apo tek studentët.</p> <p>Gjatë takimit me drejtues të IAL KUB dhe Përgjegjësën e Departamentit të Menaxhimit, GVJ u informua se raportet e NjsBC analizohen në mbledhjet e departamentit dhe të njësisë kryesore (merren masa për zgjidhjen e tyre rast pas rasti). Është detyrë e autoriteteve drejtuese brenda fakultetit dhe njësisë bazë që të angazhohen për të adresuar drejtë zgjidhjen e problemeve dhe për të shmangur rreziqet potenciale.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>4. Pyetesi studentit (formati).pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC dhe drejtues të IAL KUB</i> <i>A5.77 Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>GVJ u informua se NjsBC monitoron dhe vlerëson cilësinë nëpërmjet mekanizmave të saj, ndërsa njësia kryesore dhe departamenti luajnë një rol kyç në kontrollin e zbatimit të masave të marra dhe analizojnë ndikimin e tyre, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë duke përfshirë në rastin konkret dhe programin e studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Nëpërmjet strategjive dhe objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve/anketimeve, dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative, IAL KUB siguron efektivitetin e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në institucion dhe në programet e studimit.</p> |

| | |
|---|--|
| | <p><i>Evidenca:</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB me stafin e NjsBC dhe drejtues të IAL KUB</i> <i>A5.77 Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Gjatë takimit me Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit në IAL KUB, GVJ u informua se ata organizojnë vazhdimisht takime me personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ, dhe studentët për informimin & ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke patur si objektiv pjesëmarrjen e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së PS MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. Zhvillohen mbledhje periodike të departamentit apo njërive kryesore me qëllim diskutimin mbi problematika të ndryshme mbi ecurinë e procesit mësimor, etj, si dhe adresimin e tyre për zgjidhje nga strukturat përgjegjëse përkatëse.</p> <p>NjsBC organizon takime dhe veprimtari periodike për ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve për sigurimin e cilësisë në IAL KUB, si dhe ka zhvilluar takime të ndryshme me stafin akademik të Departamentit të Menaxhimit për të diskutuar mbi proceset e vlerësimit të programeve të studimit, vlerësimin e programit të lëndëve, si dhe çështje të tjera që lidhen me sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidenca:</i> <i>A6.72 Rregullore e NJSBC.pdf</i> <i>12. Vendimi krijimit te NJSBC.pdf</i> <i>A6.79 Raporti i IQE.pdf</i> <i>4. Pyetesori studentit (formati).pdf</i> <i>A6.73 Raporti i veprimtarise NJSBC.pdf</i> <i>Takimi në IAL KUB</i> <i>A5.77 Urdheri Rektori per ngritjen e GVB NR 11.1 dt 29.12.2022.pdf</i> <i>A6.80 Pyetesor Muaji Janar 2023.pdf</i> <i>A5.78 Sondazhi i NJSBC.pdf</i> <i>RVB e IAL KUB</i></p> |

| | | | |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|
| Konkluzione | <i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara, lidhur me këtë standard konstaton që IAL e ka përmbushur plotësisht atë.</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | | | |
|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Përmbushet plotësisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit - KUB”**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Personel akademik i kualifikuar.
2. KUB ka krijuar mekanizma dhe procedura fleksibël dhe lehtësisht të adaptueshme.
3. Aktivitete ekstrakurrikulare që plotësojnë procesin e të nxënësve dhe lidhin programin e studimit me praktikën dhe e bëjnë më tërheqës.
4. Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), një strukturë e cila krijon mundësi mjaft të mira për studentët dhe personelin akademik si dhe e lidh programin e studimit me tregun e punës.

Pika të dobëta

1. Interes jo i duhur në ndërkombëtarizimin e programit të studimit. Pjesëmarrje e ulët e studentëve në shkembimet ERASMUS+. [Standardi II.6/Kriteri 1]
2. Mungon një raport i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi. Pra, duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifikoheshin dhe të parashikoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vetë!). [Standardi IV.5/Kriteri 1; Standardi IV.5/Kriteri2]

Rekomandime

1. Disiplinat dhe programet e lëndëve duhet të reflektojnë përputhje më të mirë me ciklin e studimeve dhe me profilin përkatës.
2. Incentivim i pjesëmarrjes së studentëve në ERASMUS+ si dhe incentivim i procesit të ndërkombëtarizimit për programin e studimit.
3. Nga konstatimi që në vitin e parë të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Administrim Publik”, 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi, dhe në vitin e parë të programit të studimit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profil “Menaxhim Marketingu”, 4 pedagogë japin nga 2 lëndë mësimi, sugjerohet në të ardhmen që të ketë angazhim dhe të pedagogëve/profesionistëve të tjerë, ekspertë të fushës, kjo në interes reciprok të IAL dhe studentëve. [Standardi IV.1/Kriteri 1 & Standardi IV.1/Kriteri 2]
4. Nga GVJ sugjerohet që IAL KUB të ketë më shumë marrëveshje me IAL të vendit dhe të huaja (për realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik, ashtu dhe për

- studentët, projekte, etj), si dhe me institucione publike & private (për realizimin e praktikës profesionale, apo për ndihmë në punimin e diplomës, etj). [Standardi IV.1/Kriteri 7]
5. Sipas drejtuesve të IAL KUB, për literaturën digjitale, kanë marrëveshje me JSTOR dhe QUESTIA (paraqitur faturë pagese nga IAL KUB lidhur me JSTOR) ... por sugjerohet nga GVJ që të vihet në dispozicion dhe marrëveshja/kontrata e plotë me ta. [Sandardi IV.3/Kriteri1; Standardi IV.3/Kriteri3; Standardi IV.3/ Kriteri 4; Standardi IV.3/Kriteri 5;]
 6. Pavarësisht se IAL KUB ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në gjuhën shqipe dhe të huaj (sidomos të viteve të fundit) për të mbështetur nevojat e programit MSH në “Menaxhim Biznesi” me profile: “Administrim Publik” dhe “Menaxhim Marketingu”. [Standardi IV.3/ Kriteri 2; Standardi IV.3/Kriteri 4;]
 7. GVJ sugjeron që të instalohen dhe disa kompjutera personalë/laptopë në bibliotekë për t’i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës. [Standardi IV.3/Kriteri 6; Standardi IV.3/Kriteri 8;]
 8. GVJ sugjeron që sistemi i hedhjes së notave të azhromohet, nga ku vetë pedagogët t’i hedhin notat në sistem, kjo për të shkurtuar kohën dhe për të siguruar efektivitet të gjithë procesit. [Standardi IV.4/ Kriteri 2; Standardi V.4/ Kriteri 3]
 9. GVJ sugjeron që duhej një raport më i plotë financiar i kostove të programit të studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për të paktën një cikël të plotë studimi.[Standardi IV.5/Kriteri 1]
 10. Nga GVJ sugjerohet që duhej dhënë plani i financimit të programit të studimit (që përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj), si dhe në planin e financimit të specifkoheshin dhe të parashkoheshin si zë shpenzimesh dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line (edhe pse mbase kjo mund të jetë përfshirë në një zë tjetër shpenzimesh, por e mira është zë në vetë!). [Standardi IV.5/Kriteri 2]
 11. GVJ sugjeron që duhej raportim deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. [Standardi IV.5/Kriteri 4]
 12. GVJ sugjeron që IAL KUB të hartojë dhe publikojë përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. [Standardi V.1/Kriteri 6]
 13. GVJ sugjeron që IAL KUB të hartojë dhe publikojë përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. [Standardi V.1/Kriteri 7]
 14. GVJ sugjeron që IAL KUB të hartojë politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. [Standardi V.1/ Kriteri 8]
 15. GVJ mendon që duhej një analizë e mirëfilltë e tregut të punës, ndër të tjera duke analizuar mundësitë e punësimit të studentëve të këtij programi, si dhe duke dhënë konkluzione & rekomandime për zhvillimin e programit në të ardhmen. [Standardi V.4/Kriteri 5]
 16. GVJ mendon që duhej më shumë informacion se cilët janë bashkëpunëtorët/ekspertët e jashtëm dhe se si përfshihen ata. [Standardi VI.2/Kriteri 2; Standardi VI.4/Kriteri 1; Standardi VI.4./Kriteri 5]

17. GVJ mendon që duhej më shumë informacion mbi përfshirjen e përfaqësuesve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ tek NjSBC. [Standardi VI.4/Kriteri 3]

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Business Management" with profiles: "Public Administration" and "Marketing Management" provided by the Higher Education Institution "University College of Business - KUB "

Strengths and Affirmations

1. Qualified academic personnel.
2. HEI KUB has created flexible and easily adaptable mechanisms and procedures.
3. Extracurricular activities that complete the learning process which connect the study program with practice and make it more attractive.
4. Institute for Studies and Applications in Business" (ISAB), a structure which creates very good opportunities for students and academic staff and connects the study program with the labor market.

Weaknesses

1. Improper interest in the internationalization of the study program. Low student participation in ERASMUS+ mobilities. [Sdandard II.6/Criterion 1]
2. There is a lack of a complete financial report of the costs of the study program and the plan for the financial support necessary for its success for at least one full study cycle. Therefore, it is needed the financing plan of the study program (which contains the financing of human resources for this program, the operating expenses for the maintenance of the environments and supporting technologies of the learning process, etc.), as well as in the financing plan to be specified and foreseen as an item of expenditure for the library and the enrichment of literature and access to on-line libraries (although this could be included in another item of expenditure, but it is recommended as an item itself!). [Sdandard IV.5/Criterion1; Sdandard IV.5/Criterion 2]

RECOMMENDATIONS

1. Disciplines and subjects/courses programs should reflect better compatibility with the cycle of studies and the relevant profile.
2. Encouraging student participation in ERASMUS+ mobilities as well as the internationalization process for the study program.
3. Considering that in the first year of the MSc study program in "Business Management" with the "Public Administration" profile, 4 lecturers teach 2 subjects/courses each, and in the first year of the MSc study program in "Business Management" with "Marketing Management" profile, 4 lecturers teach 2 subjects/courses each, it is suggested that in the future there should be engagement of other lecturers/professionals, field experts, this is in the mutual interest of HEIs and students. [Sdandard IV.1/Criterion 1 & Sdandard IV.1/Criterion 2]
4. It is suggested by EEG that HEI KUB to have more agreements with HEIs of the country and abroad (for joint scientific conferences for both academic staff and students, projects, etc.), as well as with public and private institutions (for professional practice, or for help in the thesis work, etc.). [Sdandard IV.1/Criterion 7]
5. According to the directors of HEI KUB, regarding digital literature, they have an agreement with JSTOR and QUESTIA (presented payment invoice from HEI KUB regarding JSTOR) ... but it is suggested by EEG that the full agreement/contract to be available. [Sdandard IV.3/Criterion1; Sdandard IV.3/Criterion 3; Sdandard IV.3/Criterion 4; Sdandard IV.3/Criterion 5;]
6. Despite the fact that HEI KUB has made considerable efforts to enrich the literature (titles) in the library, there is still room for adding book titles in Albanian and foreign languages (especially from recent years) to support the needs of the MSc program in "Management Business" with profiles: "Public Administration" and "Marketing Management". [Sdandard IV.3/Criterion 2; Sdandard IV.3/Criterion 4;]
7. EEG suggests that some personal computers/laptops to be installed in the library to better serve students' navigation in online literature resources. [Sdandard IV.3/Criterion 6; Sdandard IV.3/Criterion 8;]
8. EEG suggests that the grading system to be updated, from where the lecturers themselves can put the grades in the system, in order to shorten the time and ensure the effectiveness of the entire process. [Sdandard IV.4/Criterion 2; Sdandard V.4/Criterion 3]
9. EEG suggests that was needed a more complete financial report of the costs of the study program and the plan for the financial support necessary for its operation for at least one full study cycle. [Sdandard IV.5/Criterion 1]
10. It is suggested by EEG that the funding plan for the study program should be given (which contains the funding of human resources for this program, operating expenses for the maintenance of the environments and supporting technologies the learning process, etc.), as well as in the funding plan to be specified and predicted as an item of expenditure for the library and the enrichment of the literature and access to the on-line libraries (although maybe this could be included in another item of expenditure, but it is recommended as an item itself!). IV.5.2
12. EEG suggests that reporting was needed up to the level of the basic unit responsible for the study program on the implementation of the approved budget of the previous year. IV.5.4
13. EEG suggests that HEI KUB to draft and publish before each academic year special criteria for the selection of candidates with special skills, minorities and marginalized groups. V.1.6

14. EEG suggests that HEI KUB to draft and publish before each academic year the criteria for the selection of candidates from other countries. [Sdandard V.1/Criterion 7]

15. EEG suggests that HEI KUB to draft aid/scholarship policies for the needy people and to increase the quality of admission to programs with priority for the institution and for the economic development of the country. [Sdandard V.1/Criterion 8]

16. EEG thinks that a proper analysis of the labor market was needed, among other things analyzing the employment opportunities of the students of this program, as well as giving conclusions and recommendations for the development of the program in the future. [Sdandard V.4/Criterion 5]

17. EEG thinks that more information was needed on who the collaborators/external experts are and how they are involved. [SdandardVI.2/Criterion 2; Sdandard VI.4/Criterion 1; Sdandard VI.4/Criterion 5]

18. EEG thinks that more information was needed on the involvement of representatives of the academic, academic and administrative staff at IQAU. [SdandardVI.4/Criterion 3]

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|--|----------------------|-----------------------|
| | | | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TERËSOR | | | | X |

